



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 363 Akti

Nr. 526 Vendimi
Tiranë, më 28.4.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja	Kryesuese
Pamela Qirko	Relatore
Roland Ilia	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Amela Idrizi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi, në datën 26.4.2022, ora 13:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore në lidhje me çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Matilda Shalla**, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH, E, Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i RSH-së”;

Ligji 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji rekomandimin e relatores së çështjes, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve bazuar në nenin 179/b, paragrafi 5, i ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe në nenin 3, pika 5 dhe nenin 5, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Matilda Shalla, gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier, i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) më 16.12.2019 zhvilloi procedurat e shortit të shpërndarjes së çështjeve në trupa gjykues, nga ku rezultoi se subjekti do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja, Pamela Qirko dhe Roland Ilia. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e parë të trupit gjykues të datës 20.12.2019, kryesues u caktua me mirëkuptim komisionerja Etleda Çiftja, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit me subjektin e rivlerësimit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit gjithashtu deklaroi¹ mospasjen e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

5. Në zbatim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, për znj. Matilda Shalla nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Procesi i vlerësimit të pasurisë, në përputhje me kreun IV të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

9. Inspektorati i Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI) ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në kuadër të kontrollit të pasurive/interesave privatë të subjektit të rivlerësimit është konstatuar se:

- deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;
- nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;
- ka kryer fshehje të pasurisë;
- ka kryer deklarim të rremë;
- subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

¹ Nëpërmjet komunikimit elektronik të datës 27.2.2020.

10. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar raportin/raportet e mbajtur/a për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

11. Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ) ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe në përfundim ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

12. Në vijim, janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara nga pika 5 e nenit 14 të ligjit nr. 84/2016. Procesi i rivlerësimit ka nisur me një hetim administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për këtë procedurë rivlerësimi.

13. Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, vlerësoi se ato arrijnë nivelin e provueshmërisë dhe në datën 28.3.2022 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht, duke u bazuar vetëm në kriterin e pasurisë për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016 dhe nenet 35-40, 45-47 të Kodit të Procedurave Administrative; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

14. Në vijim, po në datën 28.3.2022, subjekti i rivlerësimit u njoftua nëpërmjet postës elektronike në lidhje me rezultatet e hetimit administrativ, analizën financiare të kryer nga Komisioni dhe metodologjinë e përgatitjes së saj, në lidhje me të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime, të drejtën për të paraqitur prova të reja apo thirrjen e dëshmitarëve, duke i dhënë kohë për ushtrimin e këtyre të drejtave, brenda një afati të arsyeshëm prej 15 ditësh. Subjekti i rivlerësimit u njoh me të gjitha aktet e dosjes më 30.3.2022, duke disponuar kopjen e saj në format elektronik (CD).

15. Në datën 7.4.2022, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet adresës elektronike, kërkoi shtyrje të afatit për të paraqitur mbrojtjen, me arsyetimin se ishte në pritje për të siguruar disa dokumente nga zyra e regjistrimit të pasurive të paluajtshme për të provuar të kundërtën e barrës së provës, duke paraqitur bashkëlidhur kërkesën drejtuar ASHK-së për vënie në dispozicion të disa akteve dhe aplikimin e datës 5.4.2022 për këtë qëllim². Pas shqyrtimit të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, me qëllim garantimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, vendosi të pranojë kërkesën e subjektit, duke e shtyrë afatin për paraqitjen e shpjegimeve deri në datën 20.4.2022.

16. Në datën 20.4.2022, subjekti paraqiti në formë elektronike shpjegimet dhe provat, si dhe njëkohësisht edhe nëpërmjet protokollit zyrtar të Komisionit³. Në përfundim të shpjegimeve, subjekti paraqiti kërkesë për riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera: atë të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, duke konsideruar se kishte arritur nivelin e besueshmërisë në vlerësimin e pasurisë.

2 Kërkesë drejtuar ASHK-së, Drejtorisë Tirana Veri, për vënie në dispozicion të historikut të pasurisë nr. ***, vol. ***, fq. ***, e llojit "apartment", me sip. 136 m², zona kadastrale ***.

³ Protokolluar me nr. *** prot., datë 21.4.2022.

17. Trupi gjykues, pas vlerësimit të kërkesës së subjektit të rivlerësimit, vendosi mospranimin e kërkesës⁴, pasi deri në atë fazë të hetimit, provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë kishin arritur nivelin e provueshmërisë, bazuar në nenin 4 pika 2 dhe nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe, nëse pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave, si dhe pas seancës dëgjimore do të provohej e kundërta e rezultateve të hetimit, trupi gjykues do të vendoste për ecurinë e procesit të rivlerësimit.

II. SEANCA DËGJIMORE

18. Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 26.4.2022, ora 13.00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati Kongreseve), salla B, kati 0, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Francesco Ciardi.

19. Subjekti i rivlerësimit u paraqit së bashku me me avokatin e caktuar prej saj me deklaram në seancë, z. A.R, me nr. licence *** dhe NUIS ***, të cilët morën kohën e duhur për të parashtruar shpjegimet në lidhje me procesin e rivlerësimit dhe rezultatet e hetimit administrativ, për sa i përket kriterit të vlerësimit të pasurisë. Në përfundim të shpjegimeve, subjekti i rivlerësimit kërkoi riçeljen e hetimit administrativ edhe për dy kriteret e tjera: të kontrollit të figurës dhe vlerësimit të aftësive profesionale, duke konsideruar arritjen e nivelit të besueshmërisë në vlerësimin e pasurisë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

20. Znj. Matilda Shalla ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur në kohë pyetësorëve/kërkesave gjatë procedurës së hetimit administrativ, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI

21. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

21.1. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit, mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

21.2. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

21.3. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

21.4. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016 parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse për kryerjen e vlerësimit profesional.

⁴ Shih korrespondencën elektronike të datës 21.4.2022.

21.5. Por, referuar vendimit nr. 2/2017⁵ të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

21.6. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pranë Komisionit dhe në seancën dëgjimore.

A. VLERËSIMI I PASURISË

22. Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja u procedua me hetimin e thelluar administrativ të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

22.1. Përtej këtij raporti nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, duke e krahasuar me deklaratimet e interesave privatë dhe dokumentet shoqëruese, paraqitur më parë në ILDKPKI, në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurive për subjektin e rivlerësimit.

22.2. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklaratimeve të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si edhe verifikimin e ligjshmërisë së të ardhurave të deklaruara si burim krijimi të pasurive. Në deklaratën “Vetting”, të dorëzuar në ILDKPKI më 27.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar respektivisht pasuritë (të luajtshme dhe të paluajtshme) si vijon:

23. Pasuria e llojit “apartament” me sip. 136 m², zona kadastrale ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. ***, rruga “****”, shkalla ***, kati ***, apartamenti nr. ***, Tiranë, blerë me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.12.2013, me palë shitëse “Raiffeisen Bank” dhe palë blerëse Matilda Shalla dhe B.Sh, vlera 174.080 euro. Zotëron 50 %.

23.1. Si burim krijimi të kësaj pasurie, subjekti ka deklaruar: “...**janë parapaguar 80.000 euro nga B.Sh bashkëpronari – ish- bashkëshorti) shih deklaratën noteriale ndërmjet *** sh.p.k dhe z.B.Sh si dhe statementet e llogarive bankare...**”.

Gjithashtu, në seksionin “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, të deklaratës “Vetting”, subjekti ka deklaruar: “...**Kredi bankare te Raiffeisen Bank me objekt “Blerje shtëpie”, shuma 95,000 euro me kontratë nr.***, dt.26.12.2013. Fillon në dt.11.3.2014-**

⁵41. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.

11.3.2030 (Bashkëkredimarrës me ish bashkëshortin B.Sh, dhe paguhet prej tij. Kolateral për kredinë është apartamenti i banimit me sip.136 m², z.k *** me nr.pasurie ***, vil. ***, faqe ***, adresa Rr. ***, shkalla ***, kati ***, ap.*** Tiranë me kontratën e hipotekës nr.*** rep, nr.*** kol, dt.23.1.2014. Gjendja e detyrimit e mbetur pa shlyer 92,122 euro...”.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

23.2. Nga verifikimi i deklaramëve vjetore është konstatuar se subjekti i rivlerësimit në DIPP/2013 ka deklaruar:

- i. Kalimin e apartamentit me nr. pasurie ***, vol. ***, fq. *** (i deklaruar në formularin e deklaramit para fillimit të detyrës) nëpërmjet vendimit nr. *** prot., datë 4.11.2013, të përbaruesit gjyqësor “****” sh.p.k., në pronësi të “Raiffeisen Bank”, i cili ishte vënë si garanci për kontratën e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 21.7.2011, të marrë nga shoqëria “****” sh.p.k., ku është administrator ish-bashkëshorti. Vlera 20,750,000 lekë.
- ii. Blerje e apartamentit të sipërcituar, sipas aktmarrëveshjes për premtim shitjeje të datës 16.12.2013, lidhur me “Raiffeisen Bank”, me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.12.2013, ndërmjet palës shitëse “Raiffeisen Bank” dhe palës blerëse Matilda e B.Sh, ku nga B.Sh janë parapaguar 80.000 euro. Vlera 174,080 euro.

Konkluzionet e ILDKPKI-së për këtë pasuri

23.3. Deklarim i rremë, mungesë burimesh të ligjshme financiare për blerjen e apartamentit me sip. 136 m², rruga “****”, Tiranë, në vitin 2007, në vlerën 127.300 euro, deklaruar me burim nga emigracioni 107.300 euro dhe 20.000 euro kredi.

23.3.1. Transaksione të dyshimta për apartamentin me sip. 136 m², rruga “****”, Tiranë, rezultojnë se është blerë në vitin 2007, në vlerën 127.300 euro, ka kaluar në favor të “Raiffeisen Bank” për kredinë e marrë nga shoqëria “****” sh.p.k., me administrator B.Sh; dhe është riblerë në vitin 2013, në vlerën 174.080 euro, për të cilat ka mungesë burimesh financiare të ligjshme.

Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri

24. Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur deklaratës “Vetting”, si dhe nga hetimi i Komisionit, kanë rezultuar këto fakte:

24.1. Në datën 16.12.2013, midis subjektit të rivlerësimit dhe “Raiffeisen Bank” është lidhur aktmarrëveshja për premtim shitjeje, me objekt vendosjen e kushteve paraprake për shitjen e pasurisë së mësipërme. Sipas kësaj marrëveshjeje, “Raiffeisen Bank” zotohet t’ia shesë këtë pasuri subjektit të rivlerësimit, në cilësinë e ofertuesit, i cili ka shfaqur interes për blerjen e saj, nëpërmjet procedurave të ankandit, në vlerën prej 174,080 eurosh.

24.2. Në këtë marrëveshje është përcaktuar se subjekti i rivlerësimit merr përsipër kryerjen e pagesës prej 80,000 eurosh në favor të “Raiffeisen Bank” brenda 5 ditëve pune, duke filluar nga data 4.12.2013, e cila do të jetë paradhënie për blerjen e pronës, ndërsa diferenca prej 94,080 eurosh mund të depozitohet në llogarinë e “Raiffeisen Bank” deri më 15.1.2014, e cila do të qëndrojë e bllokuar deri në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes së kësaj pasurie.

24.3. Në datën 26.12.2013, midis “Raiffeisen Bank” në cilësinë e kredihënësit, si dhe subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit të saj, në cilësinë e bashkëkredimarrësve, lidhet kontrata e kredisë bankare⁶, me objekt kreditimin e shumës prej 95,000 eurosh me objekt blerje shtëpie, me afat 300 muaj, kredi e cila rezultojnë e disbursuar në favor të subjektit dhe personit të lidhur në datën 11.2.2014 dhe transferuar në favor të palës shitëse “Raiffeisen Bank” në datën 12.2.2014, me përshkrimin “pagese per lik kontrat ret *** kol/*** dt 30.12.2013”.

⁶ Kontrata e kredisë bankare me nr. *** rep., nr. *** kol.

24.4. Në datën 30.12.2013 është lidhur kontrata e shitjes⁷ së pasurisë midis “Raiffeisen Bank” në cilësinë e shitësit, si dhe subjektit të rivlerësimit dhe ish - bashkëshortit të saj në cilësinë e blerësve, për blerjen e apartamentit të mësipërm, kundrejt çmimit 174,080 euro, i shlyer plotësisht.

24.5. Në datën 14.1.2014 pasuria është regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit të saj.

24.6. Në datën 23.1.2014, pasuria është vendosur hipotekë⁸ në favor të “Raiffeisen Bank” për sigurimin e përmbushjes së detyrimit të kredisë, hipotekë e cila figuron e regjistruar në favor të bankës më 3.2.2014.

24.7. ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tiranë⁹ konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie në emër të subjektit të rivlerësimit dhe ish-bashkëshortit të saj.

24.8. Nga verifikimi i dokumentacionit¹⁰ të depozituar në regjistrin e pasurive të paluajtshme rezulton se fillimisht pasuria është përfituar me kontratën e shitjes¹¹ së pasurisë së paluajtshme të datës 1.7.2011, të lidhur midis shoqërisë “****” sh.p.k. në cilësinë e shitësit dhe z. B. Sh në cilësinë e blerësit, kundrejt çmimit prej 108,800 eurosh, i paguar plotësisht jashtë zyrës noteriale.

24.9. Kjo pasuri rezulton të jetë vendosur si garanci hipotekore në favor të “Raiffeisen Bank”, sipas kontratës së hipotekës¹² të datës 27.7.2011, të lidhur midis subjektit të rivlerësimit, z. B.Sh, shtetasve B dhe E.M, shoqërisë “****” sh.p.k., në cilësinë e hipotekuesve të 5 apartamenteve të tjera, të ndodhura në Kavajë (3 në pronësi të B.M dhe 2 në pronësi të “****” sh.p.k.) dhe shoqërisë “Raiffeisen Bank” nga ana tjetër, në cilësinë e përfituesit të hipotekës, për të garantuar përmbushjen e detyrimit të kredisë, sipas kontratës me kufi¹³ të datës 27.7.2011, të lidhur midis “Raiffeisen Bank” dhe shoqërisë “****” sh.p.k., me administrator z. B.Sh, me objekt kreditimin e shoqërisë në shumën 350,000 euro.

24.10. Nga hetimi ka rezultuar se “Raiffeisen Bank”, në cilësinë e kreditorit, i është drejtuar gjykatës për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit¹⁴ mbi kontratën e kredisë, për shkak të vonës në shlyerjen e detyrimit nga shoqëria “****” sh.p.k. Pas përfundimit të procedurave përmbartimore të ekzekutimit rezulton se pasuria është regjistruar në pronësi të kësaj banke sipas *Vendimit për kalimin e sendit të paluajtshëm në pronësi të blerësit* nr. *** prot., datë 4.11.2013, të shoqërisë përmbartimore “****”.

24.11. E pyetur nga Komisioni në lidhje me mosdeklarimin e kësaj pasurie në DIPP/2011, subjekti ka sqaruar se kjo pasuri është e njëjtë me atë të deklaruar në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës dhe duke qenë se nuk kishte ndryshime pas lidhjes së kontratës përfundimtare, nuk është pasqyruar ky fakt në deklaratën e interesave periodikë të këtij viti.

24.12. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se në kohën e lidhjes së kontratës së shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.7.2011, marrëdhënia e saj me ish-bashkëshortin ishte ndërprerë që prej dy vitesh dhe për këtë arsye ai figuron i vetëm si palë blerëse.

⁷ Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol.

⁸ Sipas kontratës së hipotekës me nr. *** rep., nr. *** kol.

⁹ Shkresë nr. *** prot., datë 28.4.2020, drejtuar ASHK-së Tiranë dhe kthim përgjigjja nr. *** prot., datë 30.9.2020 nga Drejtoria Vendore Tirana Veri.

¹⁰ Shih dokumentacionin e administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë, vijon nga seksioni me nr. ***.

¹¹ Kontrata e shitjes së pasurisë së paluajtshme me nr. *** rep., nr. *** kol.

¹² Kontrata e hipotekës me nr. *** rep., nr. *** kol.

¹³ Kontratë me kufi me nr. *** rep., nr. *** kol.

¹⁴ Me vendimin nr. ***, datë 6.3.2013, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është lëshuar urdhëri mbi titullin e ekzekutimit për kontratën e kredisë.

24.13. Nga verifikimi i deklaratës para fillimit të detyrës (viti 2007) u konstatua se subjekti ka deklaruar: *Apartament banimi me sip. 117, 5 m², rruga “****”, pallati i ri, *** Shpk, hyrja nr ***, Ap nr. ****, blerë në datë 04.05.2007. Vlera 127,300 euro. Burimi i krijimit: Kredia nga NBG 20,000 euro. Të ardhura nga emigracioni 107,300 euro.” Pjesa takuese 50%, por nuk kishte paraqitur dokumentacion justifikues.*

24.14. Nga analiza e shpjegimeve të subjektit, kontratës së shitblerjes së vitit 2011 dhe hetimit administrativ¹⁵ nuk u konstatua asnjë lidhje me pasurinë e deklaruar për herë të parë nga subjekti.

24.15. Nga informacioni i marrë nga Furnizuesi i Shërbimit Universal¹⁶ konstatohet se në emër të z. B.Sh është lidhur kontrata e furnizimit me energji elektrike që nga data 11.4.2007, me të dhëna: nr. kontrate ****, kabina “****” sh.p.k.

24.16. Komisioni vlerësoi të shtrijë hetimin në lidhje me pasurinë “apartament banimi”, me sip. 117,5 m² deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit, duke i kërkuar informacion ASHK-së, e cila¹⁷ nuk ka konfirmuar të dhëna për këtë pasuri.

24.17. Në vijim të hetimit, Komisioni i ka kërkuar informacion shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. në lidhje me veprimet juridike të kryera nga shtetasit Sh për porositjen/blerjen e pasurive të paluajtshme, si dhe vënien në dispozicion të kontratave/akteve përkatëse të lidhura midis palëve, për të cilat ka informuar¹⁸ Komisionin se për shkak të kohës së kaluar dhe lëvizjes së zyrave, nuk kanë arritur të gjejnë informacionin e kërkuar, duke dërguar vetëm aktet e disponuara: kontratë shitjeje¹⁹ të datës 1.7.2011, të pasurisë objekt vlerësimi “apartment” prej 136 m², si dhe kontratë shitjeje²⁰ garazhi të datës 9.4.2012, pasuri e cila do të trajtohet më poshtë.

24.18. Pas analizimit të fakteve të rezultuara nga hetimi administrativ dhe bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar se pasuria objekt vlerësimi me sipërfaqe prej 136 m² është e njëjtë me pasurinë e deklaruar për herë të parë “apartament banimi” prej 117,5 m² për sa: (i) nga hetimi i Komisionit nuk u gjetën lidhje midis dy pasurive, si dhe nuk përputhen të dhënat midis tyre; (ii) subjekti nuk ka deklaruar saktë në përputhje me ligjin nr. 9049/2003 pasurinë “apartament”, me sip. 136 m², pasi nga hetimi rezultoi se kjo pasuri është blerë në vitin 2011 dhe është vënë hipotekë në favor të “Raiffeisen Bank” po në këtë vit; (iii) subjekti ka pasur detyrimin²¹ e deklarimit të kësaj pasurie në vitin e krijimit, burimin e krijimit dhe gjendjen e të drejtave reale mbi këtë pasuri; (iv) subjekti ka pasur detyrimin e deklarimit në lidhje me ndryshimin e interesave privatë/të drejtave reale mbi pasurinë “apartament” prej 117,5 m², deklaruar për herë të parë në deklaratën para fillimit të detyrës.

Mbi burimet e krijimit dhe mënyrën e shlyerjes së çmimit të blerjes së pasurisë

a) Në lidhje me apartamentin prej 136 m², në rrugën “*”, Tiranë***

25. Komisioni vlerësoi të ndalojë në analizimin e regjimit të pasurive të krijuara nga martesja e subjektit të rivlerësimit me personin e lidhur me të, duke qenë se gjatë hetimit administrativ, është konstatuar qëndrimi i vazhdueshëm i subjektit në lidhje me përgjegjësinë ndaj bashkësisë ligjore, kur është pyetur për burimet e krijimit të pasurive.

¹⁵ Shih dokumentacionin e ardhur nga ZVRPP-ja Tiranë me shkresën nr. **** prot., datë 4.4.2008, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁶ Shkresë nr. **** prot., datë 16.2.2022, e FSHU-së.

¹⁷ Shkresa nr. **** prot., datë 17.3.2022.

¹⁸ Shkresë kthim përgjigjeje e datës 14.2.2022; protokolluar me nr. **** prot., datë 15.2.2022.

¹⁹ Kontratë shitjeje apartamenti me nr. **** rep., nr. **** kol.

²⁰ Kontratë shitjeje garazhi me nr. **** rep., nr. **** kol.

²¹ Neni 4 pika 1 e ligjit nr. 9049/2003.

25.1. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë me z. B.Sh në datën 17.4.2003²². Me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ***, datë 17.2.2014, i cili ka marrë formë të prerë më 5.3.2014, është zgjidhur martesë, bazuar në aktmarrëveshjen “Për zgjidhjen e martesës me pëlqim reciprok” me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 6.2.2014.

25.2. Sipas kësaj marrëveshjeje, ish-bashkëshortët kanë rënë dakord të rregullojnë pasojat nga zgjidhja e martesës në lidhje me lënien për rritje dhe edukim vajzës së tyre K.Sh subjektit të rivlerësimit, përcaktimin e detyrimit për ushqim nga ish-bashkëshorti në shumën 50,000 lekë/muaj, shpenzimet e shkollimit të vajzës në shkollën “****”, duke filluar nga vlera 7,600 euro, ndërsa pasuritë nuk kanë qenë objekti i kësaj marrëveshjeje.

25.3. E pyetur²³ nga Komisioni në lidhje me rregullimin e regjimit pasuror me ish-bashkëshortin, subjekti ka sqaruar se: “*Regjimi pasuror ndërmjet meje dhe ish bashkëshortit është regjim pasuror ligjor. Deri në këto momente pasojat e tij nuk janë zgjidhur ende për shkak të ekzistencës së kredisë për apartamentin e banimit*”.

25.4. Bazuar në nenin 81 të Kodit të Familjes, në regjimin e bashkësisë ligjore bashkëshortët përgjigjen bashkërisht për pasuritë e krijuara gjatë martesës, për këtë arsye, në analizën financiare për blerjen e apartamentit në vitin 2011 do të përfshihen të ardhurat e përfituara nga subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti i saj, për të cilat janë deklaruar dhe paguar detyrimet tatimore, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nga ku rezultoi pamjaftueshmëria financiare në shumën – 13,713,142 lekë për të përballuar me burime të ligjshme blerjen e pasurisë dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera deri në këtë datë.

25.5. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e konstatimit, në vijim të së cilës subjekti paraqiti shpjegime dhe prova që do të analizohen së bashku me shpjegimet e tjera në fund të trajtimit të të gjitha çështjeve që lidhen me pasurinë objekt vlerësimi.

b) Në lidhje me apartamentin nr. *, me sip. 117,5 m², në rrugën “****”, Tiranë**

26. Në lidhje me kërkesën²⁴ e Komisionit për burimin e krijimit dhe mënyrën e shlyerjes së çmimit, subjekti ka shpjeguar se një pjesë e çmimit është siguruar nëpërmjet kredisë pranë “NBG Bank” dhe pjesa tjetër nga të ardhurat e ish-bashkëshortit B.Sh nga emigracioni. Çmimi i pasurisë është shlyer në mënyrë të alternuar, një pjesë me derdhje *cash* dhe pjesa tjetër është shlyer me *klering*, nëpërmjet shërbimeve të furnizimit dhe instalimit të sistemit të mbrojtjes nga zjarri në objektin “****” që po ndërtohej nga shoqëria “****” sh.p.k., të kryera nga shoqëria e zotëruar nga ish-bashkëshorti i saj, në këmbim të vlerës së detyrimit për apartamentin e porositur pranë kësaj kompanie²⁵. Subjekti ka vënë në dispozicion të Komisionit një kopje të mandatarkëtimit të datës 5.2.2007, në shumën prej 30.000 (tridhjetë mijë) euro me përshkrimin “*Parapagim pallat të *****”.

26.1. E pyetur²⁶ për të ardhurat e ish-bashkëshortit nga emigracioni, nëse mbi to janë paguar detyrimet tatimore, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti ka bashkëlidhur përgjigjen e z. B.Sh, i cili ka sqaruar se nuk ka paguar asnjë detyrim tatimor në Shqipëri për të ardhurat e sjella nga puna e kryer në shtetin grek dhe për më tepër sigurimi i dokumentacionit është i pamundur, pasi për autoritetet greke njihej me një emër tjetër.

26.2. Ndërsa në lidhje me burimin tjetër kredi në shumën 20.000 (njëzet mijë) euro marrë nga “NBG Bank”, subjekti ka sqaruar se kredia është shlyer nga ish-bashkëshorti i saj dhe se një

²² Referuar shkresës nr. *** prot., datë 9.12.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile.

²³ Shih pyetësin nr. ***

²⁴ Shih pyetësin nr. ***.

²⁵ Deklarimi i ish-bashkëshortit, si pjesë e përgjigjes së subjektit të rivlerësimit.

²⁶ Shih pyetësin nr. **, ku është pyetur për të ardhurat e bashkëshortit nga emigracioni, deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës.

pjesë nga detyrimi, pra, shuma prej 3623 eurosh është ekzekutuar nga llogaria e saj e depozitës. Subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës aktet: i) kopje të njësuar të kontratës së kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.10.2004, lidhur mes Bankës Kombëtare të Greqisë dhe B e Matilda Shalla; ii) kopje të deklaratës “*statement*” të pagesave të kredisë; iii) balancë dhe “*statement*” i pagesave; iv) vërtetim i datës 20.10.2016 nga “NBS Bank”; v) kopje e njësuar e urdhrimit të transferimit nr. *** prot., nr. *** regj., datë 13.9.2016 e studios përmbarimore “****” dhe kërkesë për transferim fondesh e datës 19.9.2016 në “Intesa SanPaolo Bank” në shumën prej 3623 eurosh nga llogaria e Matilda Shalla.

26.3. Komisioni analizoi dokumentacionin e paraqitur nga subjekti, ku vëren se në datën 28.10.2004, subjekti i rivlerësimit dhe z. B.Sh kanë lidhur kontratën e kredisë²⁷ me Bankën Kombëtare të Greqisë, me objekt kreditimin në shumën 20,000 euro, me qëllim blerjen e një apartamenti në rrugën “****”, ap. ***, kati ***, sip. 72 m², Tiranë, kundrejt çmimit 55,000 euro²⁸ sipas kontratës së sipërmarrjes²⁹ të datës 10.7.2004, të lidhur midis shoqërisë sipërmarrëse “****” sh.p.k. dhe porositësit B.Sh dhe se me disbursimin e kredisë shuma prej 19,628 eurosh ka kaluar në llogari të shoqërisë sipërmarrëse.

26.4. Për sigurimin e përbushjes së detyrimit të kësaj kredie, është vendosur hipotekë në favor të kësaj banke pasuria me nr. ***, e ndodhur në zonën kadastrale ***, apartament njëkatësh në rrugën “****”, Tiranë, në pronësi të shtetasve O, Sh dhe Xh.H.

26.5. Trupi gjykues, pas analizimit të dokumentacionit dhe shpjegimeve të subjektit, në kushtet kur u konstatua se: a) nuk rezultoi të vërtetohej deklarimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën para fillimit të detyrës në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë “apartament banimi” prej 117,5 m², pasi nga hetimi i Komisionit rezultoi se kredia në shumën 20,000 euro ka shërbyer për blerjen e një apartamenti tjetër, atë me nr. ***, me sip. 72 m², sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 10.7.2004; b) nuk provohej ligjshmëria e burimit tjetër, të ardhurat e përfituara nga ish-bashkëshorti nga emigracioni, në kuptim të nenit D pika 3 e Aneksit të Kushtetutës; c) subjekti, gjithashtu, nuk ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës apartamentin me nr. ***, sip. 72 m², në rrugën “****”, Tiranë, apo gjendjen e të drejtave reale mbi këtë pasuri, i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

c) Në lidhje me apartamentin prej 136 m² të riblerë nga “Raiffeisen Bank” në vitin 2013

27. Subjekti ka deklaruar në deklaratën “Vetting” se apartamentin prej 136 m² e ka blerë në shumën 174.080 euro me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.12.2013, me burim krijimi: parapaguar shuma 80.000 euro nga ish-bashkëshorti, ndërsa pjesën tjetër kredi bankare nga “Raiffeisen Bank” në shumën 95,000 euro.

27.1. Komisioni ka hetuar për sa deklaruar nga subjekti në lidhje me burimet e krijimit, ligjshmërinë e krijimit të të ardhurave që kanë shërbyer për pagesën e çmimit të blerjes prej 174,080 euro, nga ku ka rezultuar si vijon:

a) Në lidhje me burimin kredi në shumën prej 95,000 eurosh

27.2. Nga hetimi³⁰ ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti i saj, në datën 26.12.2013 kanë lidhur me “Raiffeisen Bank” kontratën e kredisë bankare³¹, me objekt kreditimin e shumës prej 95,000 eurosh me objekt *blerje shtëpie*, me afat prej 300 muaj, kredi e cila rezulton e disbursuar në favor të subjektit dhe personit të lidhur në datën 11.2.2014 dhe e transferuar në favor të palës shitëse “Raiffeisen Bank” në datën 12.02.2014 me përshkrimin

²⁷ Kontrata e kredisë me nr. *** rep., nr. *** kol.

²⁸ Rezulton sipas kontratës se ky çmim është përcaktuar të shlyhet me këste.

²⁹ Kontrata e sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol.

³⁰ Shkresë nr. *** prot., datë 7.5.2020 dhe shkresë nr. *** prot., datë 29.10.2021.

³¹ Kontrata e kredisë bankare nr. *** rep., nr. *** kol.

27.8. Konstatohet se z. B.Sh ka deklaruar në DIPP/2011 në seksionin e vendqëndrimit tjetër adresën “Rr ***, Kompleksi ***, ***”. për të cilin rezulton se është lidhur kontratë furnizimi me energji elektrike në datën 7.6.2011”³⁷).

27.9. Nga faktet e rezultuara nga hetimi u konstatua se adresa e apartamentit e evidentuar në kontratën aktive të energjisë elektrike në emër të B.Sh është e njëjtë me adresën e pasurisë me sip. 163,43 m², blerë prej tij në datën 13.7.2010, sipas kontratës së shitblerjes me rezervë të pasurisë së paluajtshme të lidhur me shoqërinë “****” sh.p.k.

27.10. Komisioni përgatiti analizën financiare me qëllim konstatimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të, për të kryer pagesën prej 130,000 euro deri në datën 2.11.2010, për blerjen e apartamentit 163,43 m² në rrugën “****”, Tiranë, me palë shitëse “****” sh.p.k., ku rezultuan me pamjaftueshmëri financiare në shumën prej -19,359,838 lekësh për të përballuar pagesën në shumën 130,000 euro dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera.

Tabela nr. 1.

	2.11.2010
A) PASURI	18,395,484
Pasuri në rrugën “****”. Në datën 13.7.2010 parapaguar 130,000 euro deri në 2.11.2010.	18,045,300
Ndryshim likuiditeti	350,184
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	18,395,484
D) TË ARDHURA	3,580,232
Të ardhura nga paga SR	702,088
Të ardhura nga paga bashkëshorti	2,878,144
E) SHPENZIME	4,544,586
Shpenzime minimale jetike	336,871
Shpenzime për këste kredie tek “NBG Bank”	226,399
Shpenzime për këste kredie tek “Raiffeisen Bank” (kredi konsumatore lekë)	153,487
Shpenzime për automjetin “****”	1,639,733
Shpenzime për automjetin tek “****”	1,526,910
Shpenzime arsimit për vajzën K.Sh	661,185
Balanca e fondeve (D-C-E)	-19,359,838

27.11. Në përfundim të hetimit dhe pas vlerësimit të fakteve, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit 84/2016 për sa konstatohet se: i) subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti i saj nuk e kanë deklaruar në DIPP/2010 krijimin e pasurisë “apartament banimi” me sip. 163,43 m²; ii) Komisioni ngre dyshimin e arsyeshëm për fshehje pasurie për sa rezultoi se pasuria “apartament” me sip.163,43 m² është krijuar gjatë martesës së subjektit të rivlerësimit, nuk është deklaruar asnjëherë në deklaratat periodike dhe se referuar informacionit të marrë nga FSHU-ja, apartamenti vazhdon të figurojë në emrin e z. B.Sh; iii) nga analiza financiare rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe ish-bashkëshorti i saj nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar plotësisht pagesën e një pjese të çmimit, në shumën 130,000 euro, për blerjen e këtij apartamenti, duke rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në shumën -19,359,838 lekë.

³⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 16.2.2022.

Analizë në lidhje me të ardhurat nga aktiviteti në shoqëritë tregtare ku z. B.Sh ka qenë ortak

28. Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore, konstatohet se subjekti dhe ish- bashkëshorti i saj nuk kanë deklaruar në seksionin e të ardhurave, të ardhura personale në formë dividendi të përfituara nga ushtrimi i aktivitetit tregtar.

28.1. QKB-ja informon se z. B.Sh ka qenë ortak në disa shoqëri tregtare:

- ortak me 25% të kuotave në shoqërinë “****” sh.p.k., regjistruar në datën 19.1.2006 me objekt aktiviteti tregti të pajisjeve elektronike dhe kaluar në likuidim në datën 9.7.2009.

- ortak me 100% të kuotave në shoqërinë “****” sh.p.k., regjistruar në datën 17.11.2015 me objekt aktiviteti në fushën e ndërtimit, e prishur pa likuidim në datën 2.9.2010, si rrjedhojë e bashkimit me përthithje tek shoqëria “****” sh.p.k. Nga verifikimi i regjistrimeve në QKB nuk u evidentua informacion në lidhje me bilancet vjetore, vendimet e asambleve për miratimin e pasqyrave financiare/rezultatit financiar vjetor/destinimit të fitim-humbjes, në lidhje me këto shoqëri.

- ortak me 100% të kuotave në shoqërinë “****” sh.p.k., regjistruar në datën 15.6.2011, me objekt aktiviteti në fushën elektronike, e prishur pa likuidim në datën 2.9.2010, si rrjedhojë e bashkimit me përthithje tek shoqëria “****” sh.p.k. Nga verifikimi i regjistrimeve në QKB evidentohet depozitimi i bilanceve vjetore 2011, 2012, 2013, por pa informacion në lidhje me përfitimin e të ardhurave në formë dividendi. Gjithashtu vërehet se mbi kuotat e shoqërisë janë vendosur disa herë ndër vite sekuestro konservative për mospagim detyrimesh ndaj të tretëve, përfshirë këtu edhe detyrimet tatimore.

- ortak me 90% të kuotave në shoqërinë “****” sh.p.k., regjistruar në datën 12.12.2011, me objekt aktiviteti tregti të pajisjeve elektronike, shoqëri e pezulluar në datën 28.1.2013. Nga verifikimi i regjistrimeve në QKB evidentohet depozitimi i bilanceve vjetore 2011, 2012, 2013, por pa informacion në lidhje me përfitimin e të ardhurave në formë dividendi. Gjithashtu vërehet se mbi kuotat e shoqërisë janë vendosur disa herë ndër vite sekuestro konservative për mospagim detyrimesh ndaj të tretëve, përfshirë këtu edhe detyrimet tatimore.

- ortak me 100% të kuotave në shoqërinë “****” sh.p.k., regjistruar në datën 06.10.2015 me objekt aktiviteti tregti të pajisjeve elektrike dhe elektronike dhe aktivitete të tjera, me status aktiv. Nga verifikimi i regjistrimeve në QKB nuk u evidentua depozitimi i bilanceve vjetore/vendimeve të asambleve për miratimin e pasqyrave financiare.

- ortak me 100% të kuotave në shoqërinë “****” sh.p.k., regjistruar në datën 9.1.2019 me objekt aktiviteti konsulencë në fushën e biznesit, me status aktiv. Komisioni nuk u thellua në verifikime të mëtejshme, pasi shoqëria është themeluar nga z. B.Sh pas zgjidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit.

- ortak me 100% të kuotave në shoqërinë “****” sh.p.k., regjistruar në datën 18.1.2019 me objekt aktiviteti në fushën ndërtimit, me status aktiv. Komisioni nuk u thellua në verifikime të mëtejshme, pasi shoqëria është themeluar nga z. B.Sh pas zgjidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimit.

- ortak i shoqërisë “****” sh.p.k. me përqindje të ndryshme takuese në kapital ndër vite deri në datën 26.12.2012, ku rezulton se i ka shitur 100% të kuotave shoqërisë “****” sh.p.k. Kjo shoqëri figuron e regjistruar në datën 19.3.2003 me objekt aktiviteti në fushën e teknologjisë elektronike. Nga verifikimi i historikut të regjistrimeve vërehet se me vendimin nr. ***, datë 15.11.2010 të ortakut të vetëm është vendosur se fitimet e mbartura të vitit ushtrimor të krijuara deri më 31.12.2009, në vlerën 8,653,349 lekë të destinohen për zmadhim kapitali, duke bërë që kapitali të arrijë vlerën 13,000,000 lekë. Pra, edhe në këtë shoqëri, pavarësisht fitimit, nuk u evidentua informacion në lidhje me të ardhura personale të ortakut, z. Sh, në formë dividendi.

- ortak me 100% të kuotave në shoqërinë “***” sh.p.k., regjistruar në datën 12.12.2006, por për këtë shoqëri, nga informacioni i marrë nga QKB, nuk janë plotësuar të dhënat/ndryshimet.

28.2. Informacioni³⁸ nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë për shtetasin B.Sh si ortak paraqitet në tabelën si vijon:

Tabela nr. 2 -Pasqyra e fitim-humbjeve të shoqërive tregtare të personit të lidhur

Emri	NIPT	Datë hapje	Fit/2006 (lekë)	Fit/2007 (lekë)	Fit/2008 (lekë)	Fit/2009 (lekë)	Fit/2010 (lekë)	Fit/2011 (lekë)	Fit/2012 (lekë)	Fit/2013 (lekë)
*** SH.P.K	***	11.05.2006	1,400,112	4,846,847	15,728,447	15,271,946	5,310,959			
**** SH.P.K	***	15.06.2011							36,497	1,809,038
**** SH.P.K	***	12.12.2011						520,103	1,928,354	405,449
**** SH.P.K	***	19.03.2003		2,149,384	3,710,226	9,941,806	60,831,930	918,557	4,173,500	

28.3. Nga administrimi i informacionit mbi rezultatin financiar të deklaruar në organin tatimor, vërehet se shoqëritë tregtare ku z. Sh ka qenë ortak kanë realizuar humbje/fitim në disa vite, por nuk provohet se nga fitimi i shoqërisë z. Sh të ketë përfituar të ardhura në formë dividendi. Gjithashtu, nuk rezulton të jenë deklaruar të ardhura nga dividendi nga subjekti/personi i lidhur në deklaratat vjetore të pasurive.

28.4. Bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Ndërsa në nenin 8, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar, parashikohet se për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale, merren si të ardhura të tatueshme: *b) të ardhurat që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo i aksionarit në shoqërinë tregtare;*

28.5. Referuar dokumentacionit provues të ardhur nga institucionet kompetente dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, nuk rezultoi që: i) personi i lidhur të ketë përfituar të ardhura në formë dividendi nga fitimi i shoqërive tregtare ku ka qenë ortak; ii) të jenë paguar detyrimet tatimore sipas ligjit nr. 8438/1998. Për rrjedhojë, nuk provohet burimi i krijimit të shumës 80,000 euro e deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, e cila ka shërbyer për parapagimin e një pjese të çmimit të apartamentit prej 136 m² në vitin 2013.

28.6. Në vijim, Komisioni përgatiti analizën financiare, me qëllim verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të kryer pagesën në shumën 80,000 euro, për likuidimin e apartamentit në Tiranë, me palë shitëse “Raiffeisen Bank”, paraqitur në tabelën si vijon:

Tabela nr. 3.

	30.12.2013
A) PASURI	11,479,925
Apartament banimi me sip. 136 m ² , zona kadastrale ***, me nr.pasurie ***, vol. ***, fq. ***, rr. “***”, shkalla ***, kati ***, apartament nr. ***, Tiranë, parapaguar 80.000 euro.	11,216,800
Ndryshim likuiditeti	263,125
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	11,479,925

³⁸ Me shresën nr. *** prot., datë 21.10.2021.

D) TË ARDHURA	1,580,743
Të ardhura nga paga SR	837,205
Të ardhura nga paga bashkëshorti	719,155
Të ardhura nga interesat e depozites me afat në "ISP Bank"	24,383
E) SHPENZIME	23,768,641
Shpenzime minimale jetike	423,072
Shpenzime për këste kredie tek "NBG Bank"	319,679
Shpenzime për këste kredie tek "Raiffeisen Bank" (kredi konsumatore lekë)	211,888
Shpenzime për transfertë "****", B.Sh	1,496,742
Shpenzime për blerje aksionesh personi i lidhur B.Sh	20,476,000
Shpenzime arsimit për vajzën K.Sh	841,260
Balanca e fondeve (D-C-E)	-33,667,823

28.7. Subjektit iu kalua barra e provës bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, për të provuar të kundërtën në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare në shumën -33,667,823 lekë në datën 30.12.2013, për të përballuar parapagesën në shumën 80,000 euro për blerjen e apartamentit prej 136 m² nga "Raiffeisen Bank".

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

29. Në prapësimet e dërguara pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka kundërshtuar faktin e të drejtave reale për tri apartamente banimi, apartament me sipërfaqe 72 m², apartament me sipërfaqe 117,5 m², si dhe apartament me sipërfaqe 136 m². Subjekti ka pretenduar se bëhet fjalë për një marrëdhënie të vetme kontraktore, me qëllim shitjen e një apartamenti, i cili, siç dhe rezulton nga përmbajtja e deklaratës, në vitin 2004, kur objekti ishte në fazat e koncept-idesë, projektohej në sipërfaqen 72 m² dhe në vijim, kur është finalizuar ndërtimi, ka rezultuar me sipërfaqen 136 m².

29.1. Subjekti ka sqaruar se në lidhje me këtë pasuri ka pasur dinamikë në lindjen e të drejtave reale mbi të, të cilat fillojnë në vitin 2004, fakt që vërtetohet edhe me deklaratën e datës 11 prill 2022, të znj. E. K, administratore e shoqërisë "****" sh.p.k, sipas së cilës vërtetohet se marrëdhënia juridiko - civile për përfitimin e këtij apartamenti ka filluar në vitin 2004, ku mes palëve kësaj shoqërie dhe shtetasit B.Sh është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes me nr. *** rep., nr. *** kol., datë 10.7.2004, për përfitimin e një apartamenti me sipërfaqe 72 m². Në kontratë palët i janë referuar sipërfaqes 72 m², pasi ndërtimi ka qenë në fazat fillestare dhe se në vijim ka pësuar ndryshime të strukturës së objektit, gjë që është reflektuar edhe në strukturën dhe sipërfaqen e apartamentit.

29.2. Gjithashtu, përmes kësaj deklarate të bërë nga përfaqësuesja e shoqërisë sipërmarrëse, subjekti ka shpjeguar se vërtetohet që mes subjektit të rivlerësimit, personit të lidhur me të, dhe shoqërisë "****" sh.p.k., nuk ka pasur marrëdhënie për blerjen e ndonjë apartamenti tjetër. E vetmja pasuri e kontraktuar është apartamenti i deklaruar në deklaratën e vitit 2007, me sipërfaqe 117,5 m².

29.3. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në DIPP/2007 ka deklaruar se ka një pasuri me sipërfaqe 117.5 m², duke i qëndruar besnik përmbajtjes së kontratës së sipërmarrjes, pasi kjo ishte sipërfaqja e apartamentit në kontratë, kjo për arsye se veranda nuk ishte përcaktuar nëse

do të konsiderohej si sipërfaqe ndërtimore e shfrytëzueshme që do të kalonte në pronësi të blerësit, apo si tërheqje kati. Në përfundim të procedurës së legalizimit, me daljen e lejes së legalizimit nr. ***, datë 10.3.2009, (*shtesave anësore*, shtesë kati, (2 kate), ndryshim destinacioni në katin ***, nga parkim në shërbime në emër të subjektit përfitues “****” sh.p.k.), ka çuar në rritjen e volumeve anësore të objektit, për rrjedhojë në shtimin e sipërfaqes së verandës së apartamentit të kontraktuar nga subjekti. Ky moment është sqaruar në kontratën finale të kalimit të pronësisë, ku në sipërfaqen e apartamentit është përfshirë dhe veranda, e cila, referuar ndryshimeve përfundimtare të objektit dhe si rrjedhojë e shtesave, është deklaruar si sipërfaqe ndërtimore dhe ka kaluar në pronësi të subjektit të deklarimit.

29.4. Më tej, subjekti ka sqaruar se çmimi 127, 300 euro, i deklaruar si çmim për blerjen e apartamentit, përfaqëson çmimin e paguar për blerjen e apartamentit dhe atë të garazhit (vendparkimit), sipas përmbajtjes së nenit 2 të kontratës së sipërmarrjes të vitit 2007. Në kontratën finale të kalimit të pronësisë, çmimi i paguar nga subjekti i rivlerësimit është 108, 800 euro, pasi përfaqëson vetëm çmimin për blerjen e apartamentit, ndërkohë që çmimi për blerjen e garazhit, në vlerën 22, 000 euro, është pasqyruar në kontratën për shitjen e pasurisë së paluajtshme, me nr. *** rep., nr. *** kol., të datës 9.4.2012. Në total, çmimi i paguar për blerjen e apartamentit dhe garazhit është 130, 800 euro. Siç mund të konstatohet, diferenca mes çmimit final 130, 800 euro të paguar për përfitimin e apartamentit dhe vendparkimit dhe çmimit të përcaktuar në deklaratën e vitit 2007, në vlerën 127, 300 euro, është vetëm 2, 700 euro. Kjo shtesë përbën pagesën për sipërfaqen e verandës pas legalizimit në vitin 2009.

29.5. Subjekti ka pretenduar gjithashtu se, fakti që është i njëjti apartament, i përfituar me kontratën finale të pronësisë në vitin 2011, vërtetohet edhe me aktin e ekspertimit nga një ekspert i licencuar në fushën e ndërtimit.

29.6. Në lidhje me mosdeklarimin në vitin e krijimit (2011) të apartamentit me sipërfaqe 136 m², subjekti ka deklaruar se: a) kjo pasuri dhe burimi i krijimit të saj është deklaruar në DIPP/2007, për të cilën nuk ka ndryshuar natyra dhe burimi i saj në kontratën finale; b) kontrata e kalimit të pronësisë nuk përfaqëson krijimin e të drejtave, ndryshimin e natyrës apo burimit, por vetëm formalizimin, me qëllim regjistrimin e pasurisë; c) ndryshimi i sipërfaqes është rrjedhojë e finalizimit të procedurës së legalizimit të iniciuar nga shoqëria “****” sh.p.k.; d) me deklarimin e vitit 2007 është përmbushur detyrimi ligjor për deklarimin e kësaj pasurie.

29.7. Subjekti ka theksuar se kjo pasuri është krijuar përpara fillimit të detyrës, me të ardhura të krijuara jo nga subjekti i rivlerësimit, por nga bashkëshorti i saj, z. B.Sh, përpara lidhjes së martesës dhe përpara fillimit të detyrës.

29.8. Në lidhje me pamjaftueshmërinë financiare për të përballuar çmimin e blerjes, subjekti u ka qëndruar të njëjtave pretendime: se të ardhurat kanë qenë nga puna e bashkëshortit në emigracion në vitin 2006, të cilat janë deklaruar në përputhje me kërkesat e ligjit në vitin 2007, përpara fillimit të detyrës së saj si magjistrate. Mosnjohja e të ardhurave nga emigracioni do të përbente një deformim të realitetit social, çka do të krijonte premisa për vlerësime joobjektive.

29.9. Në lidhje me riblerjen e apartamentit prej 136 m² në vitin 2013, subjekti u ka qëndruar të njëjtave pretendime, siç është trajtuar më lart, sa u përket burimeve dhe mënyrës së pagesës. Subjekti gjithashtu ka theksuar se nuk ka pasur dijeni në lidhje me apartamentin e blerë nga ish-bashkëshorti në vitin 2010, pasi, siç ka referuar edhe në DIPP/2010 ka qenë në proces divorci me z. Sh, proces i cili është finalizuar në shkurt të vitit 2014, me pëlqim reciprok.

29.10. Ajo ka theksuar se nisur nga natyra e marrëdhënies që ka ekzistuar mes saj dhe personit të lidhur me të, përgjatë ndërprerjes së bashkëjetesës nga viti 2010, e ka bërë të pamundur për subjektin të ishte në dijeni të situatës financiare, veprimtarisë ekonomike dhe tregtare. Shuma 80, 000 euro, e paguar për blerjen e apartamentit, është konsideruar si një detyrim moral ndaj subjektit dhe fëmijës së mitur, duke qenë se humbja e banesës në procedurat e ekzekutimit të

detyrueshëm ka ardhur për shkak të një detyrimi financiar të kredituar për llogari të shoqërisë në pronësi të z.B.Sh. Subjekti ka paraqitur disa akte në cilësinë e provës³⁹.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

30. Trupi gjykues, pasi administroi shpjegimet e subjektit të paraqitura në Komision dhe relatuar në seancën dëgjimore, si dhe shqyrtoi provat e paraqitura prej saj në lidhje me çështjet e rezultuara nga hetimi administrativ për pasurinë e deklaruar në “Vetting”, apartament banimi me sipërfaqe 136 m², vëren se:

30.1. Në lidhje me apartamentet e kontraktuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, të cilat u konstatuan gjatë hetimit të pasurisë apartament prej 136 m², të ndodhura në të njëjtin pallat me të, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se ato lidhen me apartamentin e vetëm të disponuar prej saj dhe personit të lidhur me të, për të cilin ka pasur dinamikë në përfitimin e të drejtave reale.

30.2. Nga analizimi i akteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në mbështetje të shpjegimeve konstatohet se përpara lidhjes së kontratës së shitblerjes⁴⁰ të datës 1.7.2011 të pasurisë “apartament” prej 136 m², ish-bashkëshorti i subjektit ka qenë i angazhuar në disa marrëdhënie të mëparshme sipërmarrjeje me shoqërinë “****” sh.p.k., me objekt porositje apartamenti; konkretisht kontrata e sipërmarrjes⁴¹ e datës 10.7.2004, me objekt porositjen e apartamentit prej 72 m², kontrata e sipërmarrjes⁴² e datës 3.4.2006, me objekt porositjen e apartamentit prej 117 m² dhe kontrata e sipërmarrjes⁴³ e datës 4.5.2007, me objekt porositjen e apartamentit prej 117 m², duke përfshirë këtu edhe hapësira të tjera.

30.3. Më tej, nga faktet dhe provat shkresore ka rezultuar se shoqëria sipërmarrëse “****” sh.p.k., ka filluar punimet për ndërtimin e një godine banimi dhe shërbime 2, 5, 8, 10, 12 kate mbi tokë, me *** kate parkimi nëntokë, në rrugën “****”, mbi bazën e lejes së ndërtimit, miratuar me vendim nr. ***, datë 16.7.2003, të KKRT-së, Bashkia Tiranë, me afat fillimi të punimeve prill 2004 - dhjetor 2008. Kjo shoqëri, në vijim, ka ndryshuar kushtet e ndërtimit nga sa ishte caktuar në këtë leje, duke kryer shtesa anësore, shtesë *** kate, si dhe ndryshimin e destinacionit në katin ***, nga parkim në shërbime, të cilat janë miratuar me vendimin nr. ***, datë 19.11.2007, të KKRRT-së, Bashkia Tiranë. Pas përfundimit të punimeve dhe kontrollit të kryer me aktin e kolaudimit, janar 2009, është lëshuar leja e legalizimit nr. *** datë 10.3.2009, e cila ka legalizuar pikërisht 2 katet shtesë, duke u bërë nga godinë 12- katëshe në 14-katëshe, si dhe shtesat anësore dhe destinacionin e katit ***. Nga analiza e fakteve që kanë ndodhur në dinamikë në lidhje me ndërtimin e godinës nga shoqëria “****” sh.p.k., të cilat janë depozituar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, vërehet se ndryshimet e kushteve teknike të ndërtimit kanë prekur edhe sipërfaqet përkatëse të apartamenteve.

30.4. Referuar lejes së ndërtimit, kontrata e parë e sipërmarrjes e datës 10.7.2004 për porositjen e apartamentit prej 72 m², është lidhur 3 muaj nga data e përcaktuar e fillimit të punimeve për ndërtimin e godinës. Më tej, nga analizimi i kontratave vijuese të sipërmarrjes, ajo e vitit 2006 dhe 2007, të cilat kanë objekt kontraktimin e apartamentit nr. ***, të ndodhur në katin e pestë,

³⁹ Deklaratë noteriale nr. *** rep., nr. *** kol., datë 4.4.2022 e z. B.Sh; deklaratë e datës 19.10.2021 e shoqërisë “****” sh.p.k; deklaratë e datës 11.4.2022 e shoqërisë “****” sh.p.k; iv) kontratë sipërmarrjeje nr. *** rep., nr. *** kol., datë 3.4.2006 dhe aktet shoqëruese; v) aktekspertimi i ekspertës ing. T.J, prill 2022; vi) kërkesë drejtuar ASHK-së Tirana Veri nga subjekti i rivlerësimit dhe kthim përgjigjeje e datës 8.4.2022, bashkë me dokumentacionin në lidhje me historikun e apartamentit prej 136 m², depozituar në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

⁴⁰ Me nr. *** rep.,nr. *** kol.

⁴¹ Me nr. *** rep.,nr. *** kol.

⁴² Me nr. *** rep.,nr. *** kol.

⁴³ Me nr. *** rep.,nr. *** kol.

me të njëjtën sipërfaqe ndërtimi prej 117 m², duket se është ngritur godina⁴⁴ dhe janë konkretizuar sipërfaqet e brendshme dhe të jashtme. Në vijim, me përfundimin e pallatit, legalizimin e tij dhe regjistrimin në regjistrin e pasurive të paluajtshme është lidhur kontrata e shitjes e datës 1.7.2011, ku sipërfaqja e apartamentit ka ndryshuar, duke u bërë 136 m² dhe ndryshimi i saj duket se lidhet me ndryshimin e kushteve teknike të ndërtimit të pallatit.

30.5. Subjekti i rivlerësimit, për të provuar dinamikën e ndryshimit të sipërfaqes teknike të pasurisë objekt vlerësimi, përveç dokumentacionit shkresor të rezultuar në regjistrin e pasurive të paluajtshme, paraqiti para Komisionit edhe një akt teknik të përgatitur nga vlerësuese e pasurive të paluajtshme, Ing. T.J, e cila pas vlerësimit të historikut të dokumentacionit tekniko - ligjor dhe matjeve teknike të kryera në apartamentin me sipërfaqe 136 m², ka konkluduar se *nga shqyrtimi i gjithë dokumentacionit tekniko –ligjor, si dhe nga inspektimi në vend i pasurisë, rezulton se apartamenti i porositur sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 3.4.2006 është i njëjtë me kontratën përfundimtare të shitblerjes të datës 1.7.2011.*

30.6. Nga analizimi i fakteve të rezultuara nga dokumentacioni provues, trupi gjykues krijoi bindjen se në lidhje me apartamentin objekt vlerësimi ka pasur dinamikë për krijimin e të drejtave reale mbi të, për shkak të ndryshimit të sipërfaqes teknike, si pasojë e ndryshimit të kushteve teknike të godinës ku ndodhet apartamenti. Nga ana tjetër, trupi gjykues vlerëson se referuar kontratave të lidhura mes palëve, vërehet se ka pasur parregullsi për të formalizuar ndryshimet e ndodhura që nga kontrata e parë e sipërmarrjes, të diktuar nga këto fakte, por gjithsesi parregullsitë e konstatuara nuk i kanë bërë të cenueshme këto kontrata, për sa janë lidhur me vullnet midis palëve dhe se bazuar në deklaratat e lëshuara nga administratorja e shoqërisë “****” sh.p.k. (datë 19.10.2021 dhe 1.4.2022) provohet se është realizuar shkaku ligjor i tyre.

30.7. Në lidhje me burimet financiare që kanë shërbyer për blerjen e apartamentit prej 136 m², trupi gjykues, pasi vlerësoi shpjegimet e subjektit se pasuria është blerë para fillimit të detyrës dhe jo në vitin 2011 kur është formalizuar kontrata e shitjes me regjistrimin e pasurisë, si dhe pasi analizoi dinamikën e fakteve në lidhje me blerjen e kësaj pasurie, i çmon ato bindëse. Referuar deklarimeve të kohës së subjektit, vërehet se subjekti e ka deklaruar pasurinë me sip. 117 m² në deklaratën para fillimit të detyrës të blerë në shumën 127,300 euro me burime të përcaktuara: kredi pranë “NBG Bank” në shumën 20,000 euro dhe të ardhura nga emigracioni në shumën 107,300 euro. Në vijim, në deklaratën e vitit 2013 deklaroi pakësimin e kësaj pasurie, për shkak të ekzekutimit nga shërbimi përmbartimor në favor të “Raiffeisen Bank”. Duke mos pasur provë tjetër në lidhje me pagesën e çmimit të blerjes së apartamentit dhe burimeve financiare, vlerë provuese marrin deklaratimet e kohës të kryera nga subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

30.8. Nga hetimi i Komisionit është provuar se një pjesë e burimeve të krijimit është siguruar nëpërmjet një kredie të marrë nga “NBG Bank” me kontratën e kredisë nr. *** rep., nr. *** kol., datë 28.10.2004, e cila, pavarësisht se është marrë për blerjen e apartamentit, sipas kontratës së sipërmarrjes të datës 10.7.2004, është deklaruar se ka shërbyer për blerjen e apartamentit deklaruar para fillimit të detyrës, ndërsa, në lidhje me të ardhurat nga emigracioni, subjekti shpjegoi se për këto të ardhura të fituara në Greqi, bashkëshorti nuk kishte paguar detyrimet tatimore.

30.9. Trupi gjykues, në këtë kontekst, çmon se për apartamentin me sip. 136 m², fituar përpara fillimit të detyrës të subjektit të rivlerësimit, burimet financiare që kanë shërbyer për krijimin e saj, nuk janë objekt i ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, trupi gjykues nuk u thellua me analizimin e ligjshmërisë së burimeve të tyre, në kuptim të nenit D pika 3 e Aneksit të

⁴⁴ Në nenin 2 të kontratës së sipërmarrjes të datës 3.4.2006 është përcaktuar se apartamenti është në ndërtim.

Kushtetutës. Për rrjedhojë, subjektit nuk iu ngarkua pamjaftueshmëria financiare e rezultuar në datën 1.7.2011 për blerjen e apartamentit.

30.10. Së fundmi, për sa i përket deklarimit të pasurisë apartament prej 136 m², trupi gjykues vlerëson se subjekti ka kryer deklarim të pasaktë, pasi nuk ka deklaruar në DIPP/ 2011 fitimin e të drejtave të pronësisë, sipas kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme të datës 1.7.2011.

30.11. Në lidhje me riblerjen e kësaj pasurie nga “Raiffeisen Bank” me kontratën e shitblerjes të datës 30.12.2013, subjekti nuk arriti të provonte mbi ligjshmërinë e burimeve të krijimit të shumës prej 80,000 eurosh, të paguar si këst paraprak nga personi i lidhur në favor të “Raiffeisen Bank”. Nga dokumentacioni ligjor i depozituar në organet kompetente për shoqëritë tregtare ku personi i lidhur ka qenë ortak, nuk rezultoi që personi i lidhur të ketë përfutur dividend dhe mbi to të jenë paguar detyrimet tatimore si të ardhura personale në kuptim të nenit 8, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 8438/1998. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultuan me pamjaftueshmëri financiare në shumën -33,667,823 lekë për të paguar me burime të ligjshme këstin prej 80,000 eurosh në datën 30.12.2013.

30.12. Në lidhje me investimin e kryer nga personi i lidhur për blerjen e apartamentit të banimit prej 163,43 m² në rrugën “****”, Tiranë, në vitin 2010, subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e rezultateve të hetimit. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se personi i lidhur me subjektin ka lidhur kontratën e shitblerjes me rezervë të pasurisë së paluajtshme⁴⁵ të datës 13.07.2010⁴⁶ për blerjen e një apartamenti me sip. 163,43 m² nga shoqëria “****” sh.p.k. dhe për blerjen e saj ka paguar shumën 130,000 euro brenda datës 2.11.2010.

30.13. Subjekti pretendoi se nuk ka qenë në dijeni të këtyre transaksioneve dhe as nuk ka pasur mundësi të ishte në dijeni për shkak të ndërprerjes së bashkëjetesës me personin e lidhur, fakt të cilin subjekti ka pretenduar se e ka deklaruar në DIPP/2010. Trupi gjykues, në lidhje me këtë pretendim thekson se, referuar nenit 81 të Kodit të Familjes, bashkëshortët përgjigjen për të gjitha pasuritë, të ardhurat, frytet e krijuara nga martesë ligjore dhe bazuar në nenin 67 të tij, ata nuk mund t’u shmangen të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga martesë. Ndërprerja e bashkëjetesës nuk është parashikuar në legjislacionin e familjes si institut ligjor që të shkarkojë bashkëshortët nga përgjegjësia e tyre kundrejt pasurive të krijuara nga martesë. Fakti se subjekti ka deklaruar në DIPP/2010 “*të ardhura nga ish bashkëshorti për vajzën*” nuk e shkarkon subjektin nga përgjegjësia ndaj bashkësisë ligjore, pasi nga hetimi rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka zgjidhur martesën me ish-bashkëshortin e saj me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. ****, datë 17.2.2014, i cili ka marrë formë të prerë në datën 5.3.2014 e për rrjedhojë, në kohën e kryerjes së këtij investimi, subjekti i rivlerësimit ka qenë e lidhur në martesë me z. B.Sh.

30.14. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar krijimin e shumës prej 130,000 euro të paguar në dy këste deri në datën 2.11.2010, për blerjen e pasurisë “apartament” prej 163,43 m² në rrugën: “****”, Tiranë, duke rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në shumën **-19,359,838 lekë**.

30.15. Si përfundim, nga analiza e fakteve si dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me pasurinë apartament prej 136 m², të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, pasi nuk ka deklaruar në deklaratën e vitit 2011 fitimin e të drejtave të pronësisë, sipas kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme të datës 1.7.2011, si dhe ka rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar riblerjen e saj në vitin 2013 nga “Raiffeisen Bank”; nuk ka deklaruar në deklaratën e vitit 2010 blerjen e pasurisë “apartament banimi” prej 163,43 m² në rrugën

⁴⁵ Nr. *** rep., nr. *** kol.

⁴⁶ Kontrata mban datën 13.7.2012, por bazuar në dokumentacionin shoqëruar duket që viti 2012 është gabim material.

“****”, Tiranë, si dhe rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e këtij apartamenti.

31. Pasuri e llojit “garazh” me sip. 22.6 m², me nr. pasurie ***, vol. ***, faqe ***, në rrugën “****”, Tiranë. Blerë me kontratën nr. ***, datë 9.4.2012, me vlerë 22.000 euro (blerë gjatë martesës nga ish - bashkëshorti). Zotëron 50 %.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

31.1. Në deklaratën e pasurisë të vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Garazh me sip. 22.6 m², z. k. ***, me nr. pasurie ***, vol. ***, faqe ***, adresa Rr. “****”, Tiranë. Blerë me kontratën nr. ***, dt. 9.4.2012, me vlerë 22.000 Euro (blerë nga bashkëshorti). Pjesa takuese 50 %.*

Konkluzionet e ILDKPKI-së

31.2. Deklarim i rremë, mungesë burimesh të ligjshme financiare për blerjen e garazhit me sip. 22.6 m², rruga “****”, Tiranë, në vitin 2012, në vlerën 22.000 euro, deklaruar me burim gjatë martesës nga bashkëshorti.

Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

32. ASHK-ja, Drejtoria Vendore Tiranë⁴⁷ konfirmon regjistrimin e kësaj pasurie në emër të subjektit të rivlerësimit. Nga dokumentacioni i administruar ka rezultuar se në datën 9.4.2012 është lidhur kontrata e shitblerjes së pasurisë së paluajtshme⁴⁸ midis shoqërisë sipërmarrëse “****” sh.p.k. dhe subjektit të rivlerësimit për shitjen e pasurisë “garazh” me sip. 22,6 m², regjistruar në zonën kadastrale ***, me nr. pas ***, vol. ***, fq. ***, në rrugën “****”, Tiranë, kundrejt çmimit 22, 000 euro. Referuar kësaj kontrate, çmimi është paguar jashtë zyrës noteriale dhe palët nuk kanë pasur pretendime në lidhje me të.

Mbi burimet e krijimit dhe mënyrën e shlyerjes së çmimit për blerjen e pasurisë

33. Konstatohet se subjekti nuk ka bërë asnjë deklaram për këtë pasuri në asnjë nga deklaratat, as në “Vetting”, as në DIPP/2012, për burimet e krijimit të të ardhurave për blerjen e pasurisë. Pasi është pyetur nga Komisioni, ka referuar të njëjtën deklaratë të ish-bashkëshortit për të ardhurat nga bizneset në të cilat ai është ortak, por për të cilat nuk ka rezultuar që z. B.Sh të ketë përfituar të ardhura në formë dividendi nga shoqëritë që kanë realizuar fitim.

33.1. Më tej, Komisioni i ka kërkuar informacion shoqërisë së ndërtimit “****” sh.p.k. në lidhje me veprimet juridike të kryera nga shtetasit Shalla për porositjen/blerjen e pasurive të paluajtshme përfshirë dhe garazhin, si dhe vënien në dispozicion të kontratave/akteve përkatëse të lidhura midis palëve, në vijim të së cilës shoqëria “****” sh.p.k. ka informuar⁴⁹ Komisionin se për shkak të kohës së kaluar dhe lëvizjes së zyrave, nuk kanë arritur të gjejnë informacionin e kërkuar, duke dërguar vetëm aktet e disponuara, kontratë shitjeje⁵⁰ garazhi të datës 9.4.2012.

33.2. Në lidhje me burimet e krijimit, Komisioni verifikoi deklaratën e pasurisë të vitit 2012, ku vëren se personi i lidhur me subjektin ka deklaruar në seksionin e ndryshimit të pasurive “*Shitje e 100% të aksioneve të kompanisë *** shpk*”, por nuk ka depozituar dokumentacion mbështetës, si dhe nuk e ka deklaruar këtë si burim krijimi të pasurisë së krijuar në këtë vit (as në vitet e tjera).

⁴⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 28.4.2020, drejtuar ASHK-së Tiranë dhe shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 30.9.2020, nga Drejtoria Vendore Tirana Veri.

⁴⁸ Kontratë me nr. *** rep., nr. *** kol.

⁴⁹ Shkresë kthim përgjigjeje e datës 14.2.2022 protokolluar me nr. *** prot., datë 15.2.2022.

⁵⁰ Me nr. *** rep., nr. *** kol.

33.3. Sipas kontratës së shitjes të datës 4.12.2012⁵¹, rezulton se zoti B.Sh i ka shitur 100% të kuotave të kapitalit prej 13,000,000 lekë kundrejt vlerës 20,000 euro, shoqërisë “****”, çmim i cili do të paguhej nëpërmjet transfertës bankare në këtë mënyrë: pagesa e parë 60 ditë pas nënshkrimit të kontratës dhe e dyta 90 ditë pas nënshkrimit të kësaj kontrate, por nuk provohet se kur janë përfituar të ardhurat nga shitja e kuotave nga personi i lidhur. Gjithsesi, këto të ardhura nuk mund të kenë shërbyer për pagesën e çmimit të blerjes së garazhit, pasi kjo pasuri është blerë në datën 9.4.2012, ndërsa kuotat janë shitur nga ish-bashkëshorti në datën 4.12.2012, veprim i cili është regjistruar në QKB në datën 26.12.2012.

33.4. Komisioni përgatiti analizën e treguesve financiarë, me qëllim verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të kryer pagesën në datën 9.4.2012, në shumën prej 22,000 eurosh, për blerjen e pasurisë “garazh”. Nga analiza financiare, subjekti rezultoi në pamjaftueshmëri të hollash në shumën -3,058,393 lekë në datën e blerjes së garazhit.

Tabela nr. 4.

	9.4.2012
A) PASURI	3,162,474
Garazh me sip. 22.6 m ² , z.k. ***, me nr. pasurie ***, me vlerë 22.000 euro.	3,073,840
Ndryshim likuiditeti	88,634
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	3,162,474
D) TË ARDHURA	371,457
Të ardhura nga paga SR	281,457
Të ardhura nga paga bashkëshorti	90,000
E) SHPENZIME	267,376
Shpenzime minimale jetike	105,768
Shpenzime për këste kredie tek “NBG Bank”	100,738
Shpenzime për këste kredie tek “Raiffeisen Bank” (kredi konsumatore lekë)	39,912
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	20,958
Balanca e fondeve (D-C-E)	-3,058,393

33.5. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën për sa rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për të justifikuar likuidimin e çmimit për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi në shumën 22,000 euro, duke rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në shumën -3,058,393 lekë.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

34. Subjekti ka shpjeguar se në deklarinë e vitit 2007, përpara fillimit të detyrës, ka deklaruar raportin dhe burimin e të drejtës së pronësisë, që rrjedh nga kontrata e sipërmarrjes së vitit 2007. Nga përmbajtja e kësaj kontrate, në nenin 2 të saj, rezulton se për shumën e përgjithshme prej 127, 300 eurosh, subjekti përfiton pronësinë në lidhje me një apartament dhe garazh, (vendparkimi).

34.1. Subjekti ka pretenduar se e ka konsideruar të përmbushur detyrimin, në momentin që është bërë deklarimi i kontratës. Ajo ka sqaruar se është e qartë që qëllimi nuk ka qenë kryerja e një deklarimi të rremë, por rënia në gabim e ardhur nga pakujdesia në përshkrimin e detajuar të të drejtave të fituara në kontratë. Mosqenia e detajuar në përshkrimin e të drejtave pronësore të krijuara, (pasuria garazh që fitohet nga kontrata), është një lapsus, të cilin e ka korrigjuar në vitin 2012, ku ka deklaruar fitimin e pronësisë mbi garazhin, në momentin që është nënshkruar kontrata finale e pronësisë. Me nënshkrimin e kontratës së vitit 2012, për kalimin e së drejtës

⁵¹ E apostiluar në këtë datë.

së pronësisë së garazhdit, duke qenë se realizimi i kësaj të drejte është ndarë nga kontrata e shitjes së apartamentit, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar atë, çka tregon se qëllimi nuk ka qenë shmangia e detyrimit.

34.2. Në përfundim, ka shtuar se deklarimi gjithsesi nuk ndryshon origjinën e krijimit të së drejtës së pronësisë, për aq sa titulli për fitimin e kësaj të drejte, mbetet kontrata e vitit 2007 dhe burimi i të ardhurave rezulton i njëjtë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

35. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi shpjegimet e paraqitura nga subjekti, analizoi kontratën e sipërmarrjes të datës 4.5.2007 paraqitur në cilësinë e provës, në raport me faktet e rezultuara nga hetimi në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi, vlerëson se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e rezultatit të hetimit, për arsye si vijon:

35.1. Referuar kontratës së sipërmarrjes të datës 4.5.2007, paraqitur si provë nga subjekti, në nenin 2 të saj është përcaktuar se porositi është i gatshëm të blejë një apartament me sipërfaqe 117,5 m², përfshirë këtu terracën, shkallët, sheshpushimet, si dhe një vendparkim me nr. ***, në katin ***, me sipërfaqe 25 m², kundrejt çmimit 127,300 euro, ku 90% të shumës totale është përcaktuar se është paguar në momentin e nënshkrimit të kësaj kontrate. Në deklaratën e fillimit të detyrës, si deklarata e parë e kohës, e plotësuar nga subjekti, nuk është deklaruar garazhi. Nga interpretimi i qëllimit të deklarimit të kryer në këtë deklaratë konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur qëllim deklarimin e të drejtave të fituara nga kontrata e sipërmarrjes së datës 4.5.2007, por ka deklaruar shprehimisht apartamentin prej 117,5 m², të blerë në datën 4.5.2007.

35.2. Trupi gjykues vlerëson se, nëse do të ishte pasaktësi në deklarimin e parë, subjekti i kishte të gjitha mundësitë për ta saktësuar këtë deklaram për sa i takon pasurisë “garazh” në deklaratën vijuese të vitit 2012, për arsye se subjekti kishte detyrimin ligjor të deklaronte ndryshimin e çdo pasurie në vetvete, apo të drejtave reale mbi të, sikurse parashikohet në ligjin nr. 9049/2003, “Për deklarimin e pasurive”, i ndryshuar. Për më tepër, udhëzimi për deklarimin e pasurive, i datës 10.10.2016, u dha mundësinë subjekteve t’i deklarorin saktësisht pasuritë në pronësi/në posedim në deklaratën “Vetting”. Por, referuar deklaratës “Vetting” konstatohet se subjekti e ka deklaruar pasurinë “garazh” të blerë me kontratën nr. ***, të datës 9.4.2012, deklarim i cili është i njëjtë me deklaratën periodike të vitit 2012.

35.3. Nga analiza e fakteve dhe duke i dhënë vlerë provuese deklarimit të kohës, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përpunohet deklarimi i subjektit për pasurinë “garazh” prej 22,6 m² me aktin e fitimit të të drejtave reale kontratë shitblerjeje të pasurisë së paluajtshme nr. *** të datës 9.4.2012.

35.4. Trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk arriti të provonte se pasuria “garazh”, e fituar para detyrës është e njëjtë me atë të fituar në vitin 2012 dhe deklaruar në deklaratën periodike të këtij viti. Për rrjedhojë, bazuar në kontratën e shitblerjes të garazhit dhe deklarimit të subjektit për blerjen e tij në datën 9.4.2012, subjekti rezultoi me pamjaftueshmëri financiare në shumën -3,058,393 lekë për të përballuar me burime të ligjshme blerjen e garazhit në vlerën 22,000 euro.

35.5. Si përfundim, nga analiza e fakteve dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm në lidhje me pasurinë “garazh” prej 22,6 m², të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, duke rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen në datën 9.4.2012.

36. Pasuri e llojit “autoveturë”, tip “****” e vitit të prodhimit 2007, me targa TR *** P, blerë në datën 7.1.2008, me kontratën e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., datë 1.7.2010, me vlerë 23.200 euro me palë shitëse shoqëria “****” sh.a. dhe palë blerëse Matilda Shalla, me objekt

“blerje makine” ku janë parapaguar 8.000 euro nga ish-bashkëshorti B.Sh dhe pas shlyerjes së kredisë bankare të “****” me nr. *** rep., nr. *** kol., me kontratë nr. ***, datë 11.1.2008, në shumën totale 15.200 euro, shlyer në datën 17.6.2010. (shlyer gjatë martesës nga ish-bashkëshorti B.Sh, për më tepër shih *statement*-et bankare). Zotëron 100 %.

Deklarimi i kësaj pasurie në vite

36.1. Në deklaratën e vitit 2007, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Makinë, autoveturë *** e vitit të prodhimit 2007 me targa TR *** P, blerë me dt. 11.1.2008, vlera 23.200 Euro*”. Burimi i krijimit: *kredi bankare “Tirana Bank”, të ardhura nga bashkëshorti.*

36.2. Në deklaratën e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Makinë, autoveturë tip *** e vitit të prodhimit 2007 me targa TR *** P, blerë me dt. 07.1.2008, vlera 23.200 Euro*”. Gjithashtu në këtë deklaratë, në seksionin e detyrimeve financiare, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “*Kredi bankare Tirana Bank për blerje makine në shumën 15,200 euro, me kohëzgjatje 5 vjet me këst mujore 320 euro. Fillon me datë 07.01.2008-07.01.2013*”.

36.2.1. Në deklaratën e vitit 2009 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shlyerjen e detyrimit në shumën 3820 euro, ndërsa në deklaratën e vitit 2010 ka deklaruar shlyerjen e plotë të pjesës së mbetur të detyrimit.

Konkluzionet e ILDKPKI-së

37. Deklarim i rremë, mungesë burimesh të ligjshme financiare për blerjen e makinës “****” me vlerë totale 23.200 euro, deklaruar me burim gjatë martesës nga bashkëshorti.

Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri

38. Në datën 15.1.2008 është lidhur kontrata e qirasë financiare⁵² (leasing) me nr. *** rep., nr. *** kol., midis shoqërisë “****” sh.a. në cilësinë e qiradhënësit dhe subjektit të rivlerësimit në cilësinë e qiramarrësit, me objekt dhënien me qira financiare sipas kushteve të posaçme të përcaktuara në shtojcën nr. ***, pjesë integrale e kontratës për blerjen e automjetit, me afat nga data e nënshkrimit deri në datën 4.1.2013.

38.1. Sipas kësaj kontrate, qiraja e pagueshme është në vlerën 15,200 euro. Qiraja e parë prej 35% të vlerës përfundimtare të sendit sipas kësaj kontrate duhet të paguhej brenda datës 15.1.2008, ndërsa qiratë në vijim do të paguheshin në bazë mujore, duke filluar nga data 5.2.2008 e më pas në datën 5 të çdo muaji deri në shlyerjen e plotë.

38.2. Në vijim, në datën 1.7.2010 është lidhur kontrata e shitblerjes nr. *** rep., nr. *** kol., midis shoqërisë “****” sh.a. dhe palës blerëse Matilda Shalla, sipas së cilës ka kaluar pronësia mbi automjetin “****”. Nga hetimi i Komisionit⁵³ ka rezultuar se DPSHTRR-ja konfirmon regjistrimin e këtij automjeti në pronësi të subjektit të rivlerësimit.

Mbi burimet e krijimit dhe mënyrën e shlyerjes së çmimit të blerjes së pasurisë

39. Nga administrimi i dokumentacionit në lidhje me qiranë financiare ka rezultuar se subjekti ka parapaguar shumën prej 8,000 euro në datën 7.1.2008⁵⁴.

39.1. E pyetur para ILKPKI-së në datën 19.12.2014⁵⁵, në lidhje me burimin e krijimit të kësaj shume, subjekti ka shpjeguar se *si shlyerja totale e kredisë pranë *** dhe parapagimi janë bërë nga B. Z. B sqaron se ka paguar vlerën 8,000 euro nga të ardhurat e kompanisë “****” sh.p.k.* Ndërsa, kur është pyetur nga Komisioni, subjekti ka sqaruar⁵⁶ se burimi i krijimit për

⁵² Referuar fakteve të rezultuara nga administrimi i dokumentacionit të ILDKPKI-së.

⁵³ Shkresë me nr. *** prot., datë 28.4.2020 e Komisionit dhe kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 12.5.2020.

⁵⁴ Referuar aktit deklaratë pagesash “*list of invoices*” lëshuar nga “****” në ILDKPKI.

⁵⁵ Shih procesverbalin mbi shpjegimet e subjektit dërguar nga ILDKPKI me shkresën nr. *** prot., datë 20.10.2021.

⁵⁶ Shih përgjigjen e pyetjes 8 të pyetësorit ***.

kryerjen e parapagimit dhe shlyerjen e detyrimit të kredisë para kohe janë të ardhurat nga kompanitë e ish - bashkëshortit z. B.Sh. Pagesat janë kryer nga llogaria e “****” sh.p.k., me NIPT ***.

39.2. Për të provuar këtë deklaram, ka referuar të njëjtën shkresë të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, trajtuar më sipër për apartamentin dhe garazhin, ku z. B.Sh ka qenë ortak i disa shoqërive, por nga hetimi ka rezultuar se ai nuk ka përfituar të ardhura në formë dividenti prej tyre.

39.3. Bazuar në dokumentacionin e rezultuar nga hetimi, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë, me qëllim verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur për të kryer likuidimin e paradhënies së çmimit të pasurisë në datën 15.1.2008, në shumën prej 8,000 eurosh. Nga analiza financiare, subjekti rezultoi me pamjaftueshmëri financiare në shumën -1,212,166 lekë për të përballuar me burime të ligjshme paradhënien në shumën prej 8,000 eurosh.

Tabela nr. 5.

	15.01.2008
A) PASURI	3,020,457
Makinë autoveturë tip “****” (23,200 euro).	2,857,834
Ndryshim likuiditeti	162,623
B) DETYRIME	1,872,374
Kredi “****” (15,200 euro)	1,872,374
C) PASURI NETO (A-B)	1,148,083
D) TË ARDHURA	63,450
Të ardhura nga paga SR	63,450
Të ardhura nga paga bashkëshorti	-
E) SHPENZIME	127,533
Shpenzime minimale jetike	17,078
Shpenzime për automjetin “****” (komisioni / siguracioni)	110,455
Balanca e fondeve (D-C-E)	-1,212,166

39.4. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit financiar negativ në shumën prej – **1,212,166 lekësh** për parapagimin e shumës 8,000 euro.

Në lidhje me shlyerjen e parakohshme të detyrimit të qirasë financiare

40. Komisioni përgatiti analizën e treguesve financiare, me qëllim verifikimin e mundësisë së subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, për të kryer likuidimin e parakohshëm të qirasë financiare në datën 17.6.2010, në shumën prej 8,880 eurosh. Nga analiza financiare, subjekti dhe personi i lidhur rezultuan me pamjaftueshmëri financiare në shumën prej – 11,652,539 lekësh për të kryer likuidimin e parakohshëm të qirasë financiare.

Tabela nr. 6.

	17.06.2010
A) PASURI	11,347,821
Pasuri në rrugën “****”, Tiranë. Parapaguar 80,000 euro, datë 27.4.2010.	11,104,800
Ndryshim likuiditeti	243,021
B) DETYRIME	0
C) PASURI NETO (A-B)	11,347,821

D) TË ARDHURA	1,778,114
Të ardhura nga paga SR	429,699
Të ardhura nga paga bashkëshorti	1,348,415
E) SHPENZIME	2,082,831
Shpenzime minimale jetike	187,853
Shpenzime për këste kredie tek “NGB Bank”	169,209
Shpenzime për këste kredie tek “Raiffeisen Bank” (kredi konsumatore lekë)	86,036
Shpenzime për automjetin “****”	1,639,733
Balanca e fondeve (D-C-E)	-11,652,539

40.1. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni i kaloi subjektit barrën e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit financiar negativ në shumën prej – **11,652,539 lekë**, për kryerjen e parapagimit të çmimit në shumën 8,880 euro dhe kryerjen e investimit në vlerën 80,000 euro për prenotimin e pasurisë pranë shoqërisë “****” sh.p.k, në Tiranë, në datën 27.4.2010, si investime të kryera për këtë periudhë nga personi i lidhur me subjektin.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

41. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se vlera prej 23.200 eurosh për blerjen e makinës është paguar nga të ardhura të realizuara nga aktiviteti tregtar i shoqërive në pronësinë e z. B.Sh. Në vlerësimin e saj, mosndarja e dividendit nuk e bën burimin e të ardhurave jo të ligjshëm.

41.1. Subjekti ka pretenduar se ndarja e dividendit, lidhet me vendimmarrjen e organit drejtues të shoqërisë tregtare, asamblesë së përgjithshme të ortakëve dhe formësimin e vullnetit të këtij organi për ndarjen e fitimit të shoqërisë. Në rastin konkret ky organ përfaqësohet nga ortaku i vetëm B.Sh dhe mosformalizimi i kësaj vendimmarrjeje nuk e bën joligjor burimin e të ardhurave, i cili rezulton të jetë një aktivitet tregtar i ligjshëm që ka pasur qarkullim të ardhurash dhe fitim. Ndarja apo përdorimi i të ardhurave, pa u respektuar procedura e ndarjes së dividendit, nuk kompromenton burimin e tyre. Pra, shkelja e procedurës për ndarjen e dividendit, apo prekja e të ardhurave të shoqërisë nga ortaku apo administratori i saj, mbetet në vlerësimin e interesave të asamblesë së përgjithshme të shoqërisë.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

42. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve të subjektit, vlerëson se ato nuk mbështeten në legjislacionin në fuqi. Legjislacioni tatimor parashikon se të ardhurat personale të rezultuara nga fitimi i shoqërisë taten, në kuptim të nenit 8, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 8438/1998, i ndryshuar. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi se personi i lidhur me të kishte përfituar dividend nga fitimi i shoqërisë dhe mbi të të ishin paguar detyrimet tatimore në kohën e përfitimit të të ardhurave.

42.1. Në lidhje me pretendimin e subjektit se ndarja e dividendit është çështje vendimarrjeje dhe nuk e bën burimin e të ardhurave nga aktiviteti tregtar i shoqërisë të paligjshëm, trupi gjykues e vlerëson të pabazuar, pasi legjislacioni tatimor njeh si burim i të ardhurave personale nga aktiviteti tregtar i shoqërisë dividendin, i cili përfitohet me mbylljen e bilancit financiar vjetor të shoqërisë të rezultuar me fitim dhe vetëm kur organi vendimarrës, asambleja e përgjithshme, vendos që fitimi të shpërndahet midis ortakëve të shoqërisë. Nga hetimi i Komisionit dhe analiza e pasqyrës së fitim - humbjeve të shoqërive të personit të lidhur, e përgatitur nga Komisioni mbi bazën e dokumentacionit ligjor⁵⁷, u konstatua se personi i lidhur nuk kishte ndarë dividend.

⁵⁷ Trajtuar në këtë vendim tabela e fitim-humbjeve të shoqërive të personit të lidhur.

42.2. Për rrjedhojë, subjekti nuk arriti të provojë dhe justifikojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave nga aktiviteti tregtar i personit të lidhur, duke rezultuar me pamjaftueshmëri financiare në shumën **-1,212,166 lekë** për pagesën e paradhënies në shumën prej 8,000 euro në datë 15.1.2008, me qëllim blerjen e automjetit tip “***” dhe në shumën **- 11,652,539 lekë** për parapagesën e vlerës 8,880 euro në datën 17.6.2010 tek “****”, për mbylljen para kohe të kredisë financiare dhe për kryerjen e investimit në vlerën 80,000 euro për prenotimin e pasurisë pranë shoqërisë “***” sh.p.k. në Tiranë në datën 27.4.2010, si investime të kryera për këtë periudhë nga personi i lidhur me subjektin. Si përfundim, nga analiza e fakteve dhe bazuar në legjislacionin në fuqi, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshëm, duke rezultuar me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera për blerjen e automjetit objekt vlerësimi dhe kryerjen e investimit për prenotimin e pasurisë pranë shoqërisë “***” sh.p.k.

ÇËSHTJE TË TJERA

Në lidhje me disa fakte të konstatuara gjatë hetimit administrativ

43. Gjatë hetimit administrativ të Komisionit janë konstatuar disa transaksione të kryera nga personi i lidhur gjatë vitit 2013. Komisioni ka administruar dokumentacionin e tërhequr nga noterit publik⁵⁸, ku vërehet se me deklaratën noteriale të datës 7.7.2013, z. B.Sh ka deklaruar se i detyrohet shtetasit G.K shumën prej 280,000 eurosh dhe për sigurimin e përmbushjes së këtij detyrimi, z. Sh ka vënë hipotekë⁵⁹ në datën 7.7.2013 apartamentin me sip. 136 m², në bashkëpronësi me subjektin e rivlerësimit, hipotekë e cila nuk figuron e regjistruar në regjistrin e pasurive të paluajtshme. Subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në DIPP/2013 detyrimin që ka pasur ish - bashkëshorti i saj ndaj shtetasit G.K si dhe hipotekën e vendosur mbi apartamentin prej 136 m².

43.1 Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime në lidhje me arsyet e transaksionit, në lidhje me mosdeklarimin në deklaratën periodike të interesave privatë të vitit 2013 të detyrimit të personit të lidhur dhe të hipotekës së vënë, si dhe t’i vërtetonte Komisionit nëse gjatë ushtrimit të detyrës si gjyqtare ka gjykuar çështje me palë ndërgjyqëse shtetasin G.K.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

44. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në deklaratën e vitit 2010 e në vijim ka deklaruar se është në proces divorci për të qenë korrekt me autoritetin përgjegjës dhe duke e vënë këtë të fundit në dijeni në kohë reale në lidhje me raportin e saj me personin e lidhur. Subjekti ka theksuar se nisur nga natyra e marrëdhënies që ka ekzistuar mes saj dhe personit të lidhur përgjatë ndërprerjes së bashkëjetesës, ka qenë e pamundur të ishte në dijeni të situatës financiare, veprimtarisë ekonomike dhe tregtare. Për rrjedhojë, ka konkluduar se ka qenë në pamundësi objektive reale për të qenë në dijeni në lidhje me aktivitetin dhe marrëdhëniet tregtare të zotit Sh me shtetasin G.K. Subjekti ka sqaruar se nuk ka gjykuar asnjë çështje me këtë shtetas dhe nuk ka pasur interesa me të. Për të provuar këtë deklaram, subjekti paraqiti në cilësinë e provës një shkresë të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier me nr. *** prot., datë 31.3.2022, sipas së cilës vërtetohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka shqyrtuar çështje me palë ndërgjyqëse shtetasin G.K gjatë periudhës së ushtrimit të detyrës si gjyqtare pranë kësaj gjykate.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

45. Sikurse është analizuar më lart, ndërprerja e bashkëjetesës nga subjekti i rivlerësimit me personin e lidhur, e cila referuar disa rrethanave të deklaruara në deklaratën e vitit 2010 e vijues, në lidhje me të ardhurat e paguara për vajzën e tyre nga personi i lidhur si “*pension ushqimor*”,

⁵⁸ Shkresë nr. *** prot., datë 25.11.2021.

⁵⁹ Referuar kontratës së hipotekimit me nr. *** rep., nr. *** kol.

duket se është faktuar në vitin 2010, nuk ka efekte ligjore në kuptim të përgjegjësive ndaj pasurive të krijuara gjatë martesës, për arsye se legjislacioni i familjes nuk e njeh si institut ligjor divorcin faktik. Nga analiza e dokumentacionit rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur kanë zgjidhur martesën në vitin 2014, ku kanë disponuar me marrëveshje për zgjidhje me mirëkuptim. Trupi gjykues vlerëson se pa dashur të paragjykojë rrethanat faktike përpara zgjidhjes së martesës, subjekti i rivlerësimit, duke qenë subjekt deklarues, duhet të kishte marrë në kohë masat ligjore për rregullimin e përgjegjësive në lidhje me pasuritë e krijuara nga martesë.

45.1. Në lidhje me detyrimin e konstatuar gjatë hetimit në shumën 280,000 euro nga personi i lidhur ndaj shtetasit G.K, trupi gjykues, pasi dëgjoji shpjegimet e subjektit, konsideroi faktin se subjekti nuk ka nënshkruar deklaratën noteriale për njohjen e këtij detyrimi dhe kontratën e hipotekës për vënie hipotekë të pasurisë “apartament” me sip. 136 m², në rrugën “****”, Tiranë, për të siguruar përmbushjen e këtij detyrimi, si dhe bazuar në parimin e objektivitetit nuk e ka ngarkoi subjektin me këtë detyrim në analizën financiare.

Në lidhje me disa transaksione të konstatuara nga hetimi administrativ

46. Nga hetimi i Komisionit u konstatuan gjithashtu disa transaksione bankare të kryera nga personi i lidhur, si vijon:

- a. në datën 21.6.2010, nga llogaria e personit të lidhur B.Sh në “Raiffesien Bank” është transferuar në llogari të shoqërisë “****” sh.p.k., shuma 11,000 euro me përshkrimin “*Pagesë kësti blerje makine*”.
- b. në datën 4.2.2013, nga llogaria e personit të lidhur B.Sh në “Intesa San Paolo Bank” është transferuar në llogari të shtetasit D.T shuma 100,000 USD me përshkrimin “*To D.A.T, kësti i parë për blerje aksionesh *** sipas kontratës lidhur datë 31.01.2013*”.
- c. në datën 8.2.2013, nga llogaria e personit të lidhur B.Sh në “Intesa San Paolo Bank” është transferuar në llogari të shtetasit D.T shuma 100,000 USD me përshkrimin “*To D.A.T, plotësim i kështit të parë për blerje aksionesh *** sipas kontratës lidhur datë 31.01.2013*”.
- d. në datën 5.6.2013 nga llogaria e personit të lidhur B.Sh në “Intesa San Paolo Bank” është transferuar në llogari të “****” shuma 10,675 euro, me përshkrimin “*Fudiciary Account services for ****”.

46.1. Komisioni i konsideroi këto shpenzime në analizën financiare paraprake⁶⁰, nga ku duket se subjekti dhe personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime financiare të mjaftueshme për të justifikuar kryerjen e transaksioneve në vitin 2010 dhe 2013, duke rezultuar me balancë negative në shumën - 19,068,830 lekë për vitin 2010 dhe për vitin 2013 në shumën - 33,538,830 lekë, për të cilin subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, si dhe iu kërkuan shpjegime në lidhje me arsyet e këtyre transfertave, mosdeklarimin në deklaratën periodike përkatëse; burimin e krijimit të shumave të transferuara; marrëdhënien e saj dhe/apo të personit të lidhur me përfituesit e këtyre shumave.

46.2. Subjekti ka shpjeguar se për shkak të ndërprerjes së jetesës së përbashkët me ish-bashkëshortin, ka qenë në pamundësi objektive për të ditur në lidhje me këto transaksione. Ajo ka shpjeguar se nuk ka gjykuar asnjë çështje me shtetasin D.T dhe nuk ka pasur interesa të lidhura me të.

46.3. Trupi gjykues vlerëson se, për të njëjtat shkaqe argumentuar më lart, për sa u provua se subjekti ka zgjidhur martesën në vitin 2014, përgjegjësia në të drejtat dhe detyrimet pasurore të krijuara gjatë martesës u takon të dy bashkëshortëve. Për këto arsye, për shkak të evidentimit të transaksioneve bankare në vitin 2010 dhe 2013, të kryera nga personi i lidhur dhe duke mos

⁶⁰ Shih tabelën në fund të vendimit.

disponuar asnjë provë që të provonte të kundërtën, trupi gjykues konkludon se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur të ardhura të mjaftueshme ligjore për të justifikuar investimet e kryera në këto vite, duke rezultuar me balancë negative në shumën - **19,068,830** lekë për vitin 2010 dhe për vitin 2013 në shumën - **33,538,830** lekë,

Në lidhje me disa pasuri të deklaruara nga z. B.Sh në deklaratën para fillimit të detyrës të subjektit të rivlerësimit

47. Në deklaratën para fillimit të detyrës të subjektit të rivlerësimit, ish - bashkëshorti i subjektit ka deklaruar si vijon:

1. *“Automjet *** blerë në vitin 2007 nga shtetasi L. K në shumën 40,000 euro. Burimi i krijimit në emër të b/shortit me vlerë 40.000 Euro. Burimi: të ardhura personale nga paga dhe emigracioni”.*

2. *“Llogari rrjedhëse te Emporiki Bank në emër të b/shortit në vlerën 60.000 Euro”.*

3. *“Llogari rrjedhëse te Banka Amerikane në emër të b/shortit në vlerën 50.000 Euro”.*

Konkluzionet e ILDKPKI-së

47.1. Mungesë burimesh të ligjshme financiare për asetet e deklaruara në vitin 2007 në emër të bashkëshortit, për automjetin dhe depozitat me vlerë totale 150.000 euro.

47.2. Pas hetimit të Komisionit⁶¹ dhe shpjegimeve⁶² të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ se llogaritë janë deklaruar gabim nga personi i lidhur, pasi u përkasin shoqërive tregtare, trupi gjykues krijoi bindjen se pasuritë, llogari bankare, të deklaruara në deklaratën para fillimit të detyrës nuk i përkisnin personit të lidhur.

47.3. Në lidhje me automjetin tip “****” deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën para fillimit të detyrës së subjektit, nga hetimi i Komisionit⁶³ ka rezultuar se me kontratën⁶⁴ e datës 23.1.2007, personi i lidhur me subjektin ka blerë automjetin me targa TR****I, nga shtetasi L.K kundrejt çmimit 500,000 lekë. Me kontratën e shitjes⁶⁵ së datës 8.4.2008 ia ka shitur shoqërisë “****” sh.p.k. kundrejt çmimit 25,000 euro. Nga verifikimi i deklaratave vjetore konstatohet se në DIPP/2008 personi i lidhur me subjektin ka deklaruar shitjen e automjetit në çmimin prej 25,000 eurosh.

47.4. Nga analizimi i dokumentacionit nuk rezultoi që personi i lidhur të kishte paguar tatimin mbi të ardhurat, për fitimin e realizuar si diferencë midis çmimit të blerjes dhe të shitjes, e për rrjedhojë Komisioni nuk i përfshiu këto të ardhura në analizën financiare paraprake të vitit 2008, për të cilin iu kalua barra e provës subjektit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit

48. Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se çmimi i vendosur në kontratë është në vlerën 500 000 lekë, ndërkohë që në deklaratën e personit të lidhur të vitit 2007, përpara fillimit të detyrës së subjektit të rivlerësimit, është deklaruar se mjete është blerë për shumën 40, 000 euro, vlera reale e blerjes së mjetit. Pikërisht, deklarimi i bërë tregon se nuk ka pasur qëllimin dhe as arsyen për të fshehur të ardhurat, duke deklaruar vlerën reale dhe jo vlerën e përcaktuar në kontratë.

48.1. Pretendimi se ka pasur mungesë të ardhurash është i pabazuar. Të ardhurat janë realizuar nga emigracioni dhe për më tepër janë realizuar përpara marrjes së detyrës nga subjekti i rivlerësimit, që do të thotë se të ardhurat e krijuara nuk kanë asnjë lidhje me ushtrimin e

⁶¹ Shkresë nr. *** prot., datë 5.10.2021 ABI (Ish-Emporiki) dhe shkresë nr. ***, datë 19.10.2021, ISP.

⁶² Shih përgjigjen e pyetjes 2 të pyetësorit ***

⁶³ Shkresë nr. *** prot., datë 3.3.2022 e DPSHTRR-së.

⁶⁴ Me nr. *** rep., nr. *** kol.

⁶⁵ Me nr. *** rep., nr. *** kol.

funksionit. Për më tepër, këto janë të ardhura të shpenzuara dhe jo të përfituara nga subjekti i rivlerësimit.

Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm

49. Trupi gjykues, pas shqyrtimit të shpjegimeve të subjektit, vlerëson se ato janë të pabazuara. Në analizën të ardhurave, Komisioni i është referuar aktit për fitimin e pronësisë mbi automjetin, kontratës⁶⁶ së datës 23.1.2007, ku është përcaktuar vlera e blerjes prej 500,000 lekë. Subjekti nuk arriti të provonte se personi i lidhur kishte paguar detyrimin tatimor të caktuar si diferencë midis çmimit të blerjes dhe shitjes, e për rrjedhojë të ardhurat e përfituara në vitin 2008 në vlerën 25,000 euro nuk u konsideruan si të ardhura të ligjshme në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me adresat e banimit deklaruar në deklaratat periodike nga subjekti dhe ish-bashkëshorti i saj

50. Gjatë hetimit administrativ është konstatuar se subjekti ka deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës, si dhe në deklaratën e interesave periodikë të vitit 2007, si adresë ku është regjistruar gjendja civile “*Njësia administrative nr. ***, Rr: “****”, Pall. ***, Tiranë*”.

50.1. Pas vlerësimit të shpjegimeve dhe provave të paraqitura nga subjekti gjatë hetimit administrativ, ku ka shpjeguar se ka banuar me qira në shtëpinë e hallës së saj T.P dhe të bashkëshortit të saj G.P, përpara se të porosiste apartamentin në rrugën “****” dhe pas hetimit të Komisionit⁶⁷ nuk u gjetën indicie për hetime të mëtejshme.

50.2. Në lidhje me deklarimin në deklaratat periodike 2016-2018 të adresës: *Njësia Administrative nr. ***, Rr “****”, pallati i ri, Nr. ***, hyrja ***, Ap. ***, Tiranë*, subjekti sqaroi dhe provoi se është adresa e apartamentit në Rr “****” ku ajo banon, adresë e cila ka ndryshuar me ndryshimet e pëgjithshme të adresave nga Bashkia Tiranë.

50.3. Ndërsa, në lidhje me adresën “*Rr ***, nr. ***, Tiranë*”, deklaruar nga personi i lidhur në deklaratën e vitit 2013, subjekti sqaroi se nuk kishte dijeni.

Në lidhje me analizën financiare nga fillimi i detyrës deri në vitin 2016

51. Në lidhje me analizën financiare nga fillimi i detyrës e deri në vitin 2016, subjekti nuk arriti të provonte të kundërtën e pamjaftueshmërisë së burimeve financiare për kryerjen e investimeve dhe shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të konstatuara gjatë hetimit administrativ, duke rezultuar me balancë negative ndër vite, përveç vitit 2011, ku nga analizimi i fakteve të konstatuara nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti, trupi gjykues krijoi bindjen se pasuria “apartament” me sip. 136 m² është blerë para fillimit të detyrës e për rrjedhojë rezultati në këtë vit ndryshoi nga negativ në pozitiv.

51.1. Subjekti rezultoi me pamjaftueshmëri financiare: i) për periudhën 5.10.2007 – 31.12.2007, me një balancë negative në shumën (- **171,396**) lekë; për vitin 2010 me një balancë negative në shumën (- **19,068,830**) lekë; ii) për vitin 2012, me një balancë negative në shumën (- **4,187,310**) lekë; iii) për vitin 2013, me një balancë negative në shumën (- **33,538,830**) lekë; iv) për vitin 2015 me një balancë negative në shumën (- **349,043**) lekë, **pra në total në shumën - (57,315,409) lekë.**

⁶⁶ Me nr. *** rep., nr. *** kol.

⁶⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 9.12.2021, të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile;

Konkluzioni në lidhje me kriterin pasuror

52. Në përfundim të vlerësimit të pasurive/të të drejtave reale, trupi gjykues arrin në përfundim se subjekti nuk arriti të provonin të kundërtën në lidhje me **pamjaftueshmërinë financiare** të rezultuar:

- a) për blerjen e apartamentit me sip. 163,43 m² në rrugën “***”, Tiranë, në datën 2.11.2010, në shumën **-19,359,838 lekë**;
- b) për blerjen e apartamentit prej 136 m² (kryerjen e pagesës së këstit të parë) në rrugën “***”, Tiranë, në datën 30.12.2013 në shumën **-33,667,823 lekë**;
- c) për blerjen e garazhit në datën 9.4.2012, në shumën **-3,058,393 lekë**;
- d) për blerjen e automjetit tip “***” (për likuidimin e parapagimit të çmimit në shumën 8,000 euro në datë 15.01.2008) në shumën **- 1,212,166 lekë** dhe likuidimin e parakohshëm të qirasë financiare financiare në datën 17.06.2010 në shumën **-11,652,539 lekë**.
- e) për kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të konstatuara gjatë hetimit administrativ që nga fillimi i detyrës e deri në viti 2016, duke rezultuar me pamjaftueshmëri financiare për periudhën nga data 5.10.2007 – 31.12.2007, balanca negative në shumën **(- 171,396 lekë)**; për vitin 2010, balanca negative në shumën **(- 19,068,830 lekë)**; për vitin 2012, balanca negative në shumën **(- 4,187,310 lekë)**; për vitin 2013, balanca negative në shumën **(- 33,538,830 lekë)**; për vitin 2015, balanca negative në shumën **(- 349,043 lekë)**, pra me një total pamjaftueshmërie financiare në shumën **- 57,315,409 lekë**.

52.2. Komisioni, bazuar në konkluzionet e mësipërme, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pamjaftueshmëri për pasuritë e krijuara gjatë martesës, për shkak të mungesës së burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe nenit 33, pika 5, germa “b”.

KONKLUZIONE PËRFUNDIMTARE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, si dhe pasi mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe në përfundim të tij, arrin në përfundimin se subjekti nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 2 të nenit 4, si edhe pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, në bazë të nenit 58, pika 1, germa “c”, si dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

V E N D O S I:

- 1.** Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Matilda Shalla, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.
 - 2.** Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerëve Publikë, vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
 - 3.** Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij.
 - 4.** Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- U shpall në Tiranë, më 28.4.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda Çiftja

Kryesuese

Roland Ilia

Anëtar

Pamela Qirko

Relatore

Sekretare gjyqësore

Amela Idrizi

ANALIZA FINANCIARE PËRMBLEDHËSE

	05.10.2007-31.12.2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016
A) PASURI	87,842	2,937,587	-444,069	41,182,496	-124,929	3,170,092	24,670,882	116,227	-12,602	-558,156
Apartament banimi me sip. 136 m ² , z.k *** me nr.pasurie ***, vol.***, fq.***, adresa Rr. "****", shkalla ***, kati ***, apartament nr. *** Tiranë.							24,407,757			
Garazh me sip. 22.6 m ² , z.k *** me nr. pasurie ***, vol.***, faqe *** adresa Rr. "****", Tiranë.						3,073,840				
Pasuri në rrugën ***. Në datë 13.07.2010 me kontratën e shitjes me rezervë *** rep nr *** kol.				40,810,140						
Makinë autoveturë tip *** e vitit të prodhimit 2007 me targa TR *** P.		2,857,834								
Ndryshim likuiditeti	87,842	79,753	-444,069	372,356	-124,929	96,252	263,125	116,227	-12,602	-558,156
B) DETYRIME	0	1,872,374	0	22,764,840	0	0	13,319,950	0	0	0
Kredi për blerje apartamenti në Raiffeisen Bank							13,319,950			
Detyrim I mbetur ndaj *** Shpk				22,764,840						
Kredi Tirana leasing		1,872,374								
C) PASURI NETO (A-B)	87,842	1,065,213	-444,069	18,417,656	-124,929	3,170,092	11,350,932	116,227	-12,602	-558,156
D) TË ARDHURA	130,045	3,611,013	2,848,184	4,105,231	4,374,022	1,942,766	1,580,743	1,610,054	1,693,971	1,723,377
Të ardhura nga paga SR	130,045	807,091	811,485	846,506	868,887	848,836	837,205	1,046,890	1,085,339	1,123,377
Të ardhura nga paga b/shorti		2,803,922	2,036,699	3,258,725	3,505,135	1,093,930	719,155			
Të ardhura nga interesat e depozites me afat në ISP Bank							24,383	13,164	8,632	
Të ardhura nga detyrimet për ushqim nga ish-bashkëshorti B.Sh								550,000	600,000	600,000
E) SHPENZIME	213,598	2,162,877	2,258,409	4,756,405	1,691,725	2,959,985	23,768,641	1,036,472	2,055,616	1,309,534
Shpenzime minimale jetike	95,447	409,860	409,860	409,860	409,860	423,072	423,072	439,996	448,552	470,184
Shpenzime për këste kredie tek NBG Bank		471,912	366,655	315,654	339,112	327,504	319,679	483,660	1,386,824	702,728
Shpenzime për këste kredie tek Raiffeisen Bank (kredi konsumatore lekë)	50,442	201,770	203,124	203,063	206,067	208,029	211,888	34,355		
Shpenzime për automjetin tek Tirana Leasing		543,721	524,007	1,639,733						
Shpenzime për automjetin tek ***				1,526,910						
Shpenzime për udhëtime jashtë vendit	67,710	262,733	162,688	0	74,682	125,748	0	78,462	220,240	136,623
Shpenzime për blerje aksionesh personi I lidhur B.Sh							20,476,000			
Shpenzime për transfertë *** B.Sh							1,496,742			
Shpenzime arsimit për vajzën K.Sh		272,880	592,074	661,185	662,004	1,875,632	841,260			
Balanca e fondeve (D-C-E)	-171,396	382,923	1,033,844	-19,068,830	2,807,227	-4,187,310	-33,538,830	457,355	-349,043	971,999